SHQIPËRIA
NË PROCESIN
E BERLINIT

TË KUPTOJMË MIGRIMIN SHQIPTAR NË GJERMANI GJATË PERIUDHËS 2014-2016

SERITË E PROCESIT TË BERLINIT

DOKUMENT PUNE: MIGRIMI / 2 / 2016

Cooperation & Development Institute
Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Hanns Seidel Stiftung

TË KUPTOJMË MIGRIMIN SHQIPTAR NË GJERMANI GJATË PERIUDHËS 2014-2016

Dhjetor, 2016

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Cooperation & Development Institute
Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Hanns Seidel Stiftung

Të kuptojmë migrimin Shqiptar në Gjermani gjatë Periudhës 2014-2016
Dokument Pune "Seritë e Procesit të Berlinit"
Migrimi/2/2016

Autorët:

Ardian Hackaj
Esmeralda Shehaj
Neshat Zeneli

Dhjetor, 2016

This publication is under Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivatives 4.0 International License (CC BY-NC-ND 4.0).

Ky Studim është pjesë e Iniciativës "Seritë e Procesit të Berlinit" mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel.

Shënim: *Opinionet e shprehura në këtë Dokument janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht asnjë pozicion të institucioneve publike ose të donatorit. Çdo gabim apo mangësi e mundshme është përgjegjësia jonë.*

Të kuptojmë Migrimin Shqiptar në Gjermani gjatë periudhës 2014-2016

PARATHËNIE

Shqipëria nuk i përket së ashtuquajturës "Rrugë e Ballkanit Perëndimor" që u përdor nga refugjatët e luftës dhe azilkërkuesit e tjerë. Edhe pas mbylljes së korridorit tranzit të migrimit, Shqipëria nuk u shndërrua në një rrugë alternative për migrantët nga Lindja e Mesme ose Afrika, ndonëse mundësia për të hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin shqiptar përmes pikave të kalimit kufitar mbetet e vlefshme.

Por, veçanërisht që nga 2015, Shqipëria është vënë në fokusin ndërkombëtar si një nga "vendet ballkanike të origjinës" të emigrimit të ligjshëm dhe të paligjshëm drejt Evropës Perëndimore dhe kryesisht Gjermanisë.

Gjatë kësaj periudhe, pothuajse 40 për qind e të gjithë azilkërkuesve të regjistruar në Gjermani erdhi nga Ballkani, ku Shqipëria dhe Kosova mbanin respektivisht vendin e dytë dhe të tretë pas migrantëve nga Siria.

Vetëm 2.6 për qind e kërkesave për azil të migrantëve shqiptarë, ku kryesonin të rinjtë e grupmoshës ndërmjet 18 dhe 35 vjeç, u pranuan si "të justifikueshme" nga institucionet gjermane të emigracionit.

Eksodi nga Ballkani ka qenë kryesisht i shtyrë nga varfëria dhe jo nga rastet e kërkesave për azil për shkak të luftës dhe dëbimit etnik, ose përndjekjes për shkak të origjinës ose statusit.

Bashkimi Europian dhe Gjermania i kategorizuan në vitin 2015 vendet e Ballkanit si Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi, si "vende të sigurta të origjinës", siç bënë në nëntor të vitit 2014 me Bosnje dhe Herzegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë.

Ndër arsyet kryesore që nxitën qytetarët shqiptarë për t'u larguar nga vendi i tyre mund të përmendim papunësinë e lartë, të ardhurat e ulëta, të cilat në përgjithësi janë më të ulëta se sa përfitimet sociale në Gjermani, mungesën e besimit tek institucionet shtetërore të cilat janë perceptuar si të korruptuara dhe jo-efikase,ndjesinë subjektive të mungesës së perspektivës për punësim, sidomos midis akademikëve të rinj dhe pritshmëritë jorealiste dhe të tepruara përsa i përket përfitimeve sociale në Europën Perëndimore, kryesisht në Gjermani.

Sfida e "migrimit tëvarfërisë" e rajonit të Ballkanit drejt Europës Perëndimore dhe Gjermanisë është kthyer ndërkohë në një çështje të rëndësishme e të ashtuquajturit "Proces i Berlinit" dhe u debatua fuqishëm në Samitin e Vjenës në 2015 dhe të Parisit në 2016.

Në Shqipëri, për momentin, nuk është kryer asnjë kërkim i mirëfilltë mbi përcaktimin e faktorëve të asaj vale mbresëlënëse.

Studimi i përgatitur nga një ekip shkencor me profesionistë të lartë të "Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) / ShtetiWeb" mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel (HSS) - Zyra e Tiranës, ka për qëllim të plotësojë këtë hendek.

Ai hulumton në një nivel gjithëpërfshirës faktorët e jashtëm tërheqës dhe faktorët e brendshëm shtytës në rastin e valës emigruese shqiptare në Gjermani dhe jep kontributin e tij përmes "mësimeve të nxjerra", duke përmirësuar kuptimin e këtij fenomeni dhe identifikimin e mjeteve më efikase për zgjidhjen e situatës.

Përmbajtja e studimit në vijim, si pjesë e dokumenteve të punës Seritë e Procesit të Berlinit" të CDI-HSS, na mundëson një ilustrim shkencor dhe një analizë të përgjithshme të profilit të migrantëve shqiptarë, shqyrton përvojat e tyre në vendin e fundit të destinacionit, në Gjermani, dhe perspektivat pas kthimit në vendin e origjinës në momentin kur iu refuzua kërkesa për azil dhe ata u konsideruan kryesisht si "punëkërkues" të cilët dëshirojnë kushte më të mira jetese.

Së fundmi, studimi është kompletuar nga ana e kontekstit të kornizës institucionale dhe ligjore mbi temën e ri-integrimit, si dhe nga konkluzionet e veçanta dhe rekomandimet për politikat.

Studimi u zhvillua nga muaji prill deri në tetor të 2016 dhe u prezantua në një diskutim të përbashkët të CDI-HSS gjatë një tryeze të rrumbullakët, mbajtur në Tiranë më 16 dhjetor 2016, ku një audiencë e gjerë e publikut dhe medias shfaqën një interes të lartë mbi këtë temë.

Hartimi i këtij studimi korrespondon plotësisht me qëllimin dhe funksionin e aktiviteteve të projekteve të Fondacionit Hanns-Seidel - Zyra e Tiranës, themeluar në vitin 1992, i cili në 2017 do të festojë 25 vjetorin e tij.

Nëpërmjet një game të gjerë seminaresh multi-sektorialë, workshop-e dhe konferenca që kanë si objektiv çështjet aktuale sociale-politike dhe tema të administratës qendrore, rajonale dhe vendore, si dhe duke iu referuar sektorit të "Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme", HSS-ja që në fillimet e saj në Shqipëri ka synuar të reagojë mbi sfidat e veçanta europiane të migrimit shqiptar.

Kjo qasje nuk është kryer vetëm për pasojat e migrimit, të cilat janë vënë në praktikë në seminaret e ogranizuara nga HSS-ja me ekspertë gjermanë për njësitë e policisë kufitare shqiptare, por ndalet gjithashtu edhe në trajtimin e shkaqeve të migrimit.

Përveç masave të ndërmarra nga policia kufitare, HSS në bashkëpunim me OJQ-të vendase dhe organizatat "think-tank" vendase me profil shkencor si CDI / ShtetiWeb ka kontribuar në përpjekjet e përbashkëta për të krijuar kushtet e nevojshme te jetesës, të cilat duhet ta bëjnë më tërheqës qëndrimin në Shqipëri, veçanërisht për brezin e ri.

Konstatimi i perspektivave për të ardhmen mund të shmangë një eksod të mëtejshëm duke kombinuar dhe mundësuar masa të veçanta arsimi që kanë për qëllim rritjen e përgjegjësive profesionale dhe sociale të shtetit dhe të nëpunësve civilë. Një vëmendje të veçantë në këtë aspekt i është kushtuar profesionalizimit të rinisë shqiptare dhe "brezit të ardhshëm". Ndryshimi i qëndrimit dhe i mentalitetit lidhur me këtë çështje të vështirë është një proces i gjatë që ka nevojë për durim, forcë, shkëmbim të kapacitetit të mësimeve të nxjerra dhe një vazhdimësi të punës së projektit, siç është bërë nga Fondacioni Hanns-Seidel - Zyra e Tiranës në të kaluarën, momentalisht dhe siç synon të jetë në të ardhmen.

Dr. Klaus Fiesinger

Drejtor Rajonal për Europën Juglindore
Fondacioni Hanns-Seidel - Zyra e Tiranës, Beogradit, Sofjes dhe Zagrebit

HYRJE:

Procesi i Berlinit, Integrimi në BE dhe Migrimi

Rëndësia e vendeve të Ballkanit Perëndimor në politikat e Migrimit të BE-së, veçanërisht në ruajtjen e kufijve të jashtëm të saj, u bë e dukshme verën e vitit 2015 pas deklaratës së Ministrit të Jashtëm të Austrisë Sebastian Kurz: "*Nëse ne nuk kemi kontrolle funksionale kufitare në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian, e gjithë ideja e një Bashkimi Europian pa kufij të brendshëm vihet në rrezik*". Zbulimi i një kamioni që përmbante trupat e 50 refugjatëve të vdekur në një autostradë austriake në gusht të vitit 2015 tronditi politikën europiane dhe futi komponentin e migrimit në axhendën e Samitittë Vjenës. Migrimi u kthye në një politikë të përgjithshme të BE-së, kurse bashkëpunimi i BE-së, në një kusht *sine-qua-non*për suksesin e tij.

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së Federica Mogherini bëri të qartë nevojën për bashkëpunim në takimin e Vjenës: "*Unë e di se mund të mbështetem - ne mund të mbështetemi - jo vetëm tek Shtetet Anëtare, por edhe tek miqtë tanë në Ballkan për* të *ndarë këtë përgjegjësi dhe solidaritet."*

Pas kësaj deklarate, sfidat që u paraqitën nga presionet e migrimit për vendet e rajonit, si dhe implikimet e "Rrugës së Ballkanit", ishin temat kryesore të Samitit të Vjenës. Parimet e përkushtimit për një politikë europiane të migrimit bazuar në kriteret e solidaritetit dhe barazisë, dhe nevoja për të ndihmuar vendet e Ballkanit për të menaxhuar situatën, ishin baza e diskutimit.

Kryetarët e shteteve dhe qeverive nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor që morën pjesë në Samit ranë dakord që për një sfidë të përbashkët, ishte i nevojshëm një reagim i përbashkët.

Sot migrimi nga vendet e treta, nga vendet kandidate dhe potencialisht kandidate, madje edhe nga shtetet anëtare (siç është rasti i Mbretërisë së Bashkuar), është kthyer në një temë mjaft të nxehtë e cila po ndikon në rezultatet e zgjedhjeve në shumë vende të BE-së. Migrimi është një çështje që do të jetë e pranishme edhe në vitet në vazhdim.

Seritë e Procesit të Berlinit: një kontributi i shoqërisë civile në integrimin rajonal

Ky dokument pune ka për qëllim të hulumtojë dhe të mundesojë një kuptim më të qëndrueshëm dhe më të plotë mbi valën e fundit të migrimit nga Shqipëria gjatë viteve 2014 - 2015, faktorët shtytës dhe tërheqës që e shkaktuan atë, përvojën jashtë vendit të migrantëve shqiptarë, profilet e tyre dhe perspektivat e të kthyerve. Studimi u zhvillua nga muaji prill deri në tetor 2016 dhe përfshin hulumtime, monitorim të medias, intervista dhe vizita në terren.

Seritë e Procesit të Berlinit filluan në nëntor të vitit 2015 në Tiranë, si një iniciativë e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ShtetiWeb mbështetur nga Fondacioni Friedrich Ebert, Fondacioni Hanns- Seidel dhe Fondacioni Konrad Adenauer. (Shiko: http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2016/02/ANGLISHT.pdf). Ato janë konceptuar si pjesë e kontributit të gjerë të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit.

Në korrik të 2016, CDI publikoi dokumentin e parë të punës mbi Komponentin e Migrimit "Shqipëria në Rrugën e Ballkanit Perëndimor: Gusht 2015 – Qershor 2016" (http://cdinstitute.eu/web/wp-content/uploads/2016/06/2016-06-23-Albania-in-the-Western-Balkans-migration-route-v.2-1.pdf).

Publikimet e plota mbi Procesin e Berlinit dhe temat e përzgjedhura mbi integrimin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, mund të konsultohen në Observatorin e Integrimit Rajonal (ORI) në faqen: http://shtetiweb.org/studime-dhe-analiza-4/

Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Hanns-Seidel.

TABELA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 7

I. KONTEKSTI 10

II. OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA 12
II.1. Qëllimi dhe objektivat e këtij studimi 12
II.2. Qasja Metodologjike 12

III. PROFILI I EMIGRANTIT: LARGIMI NGA SHQIPËRIA PËR HERË TË PARË 13
III.1. Profili demografik dhe social 13
III.2. Arsimi dhe aftësitë profesionale 13
III.3. Situata profesionale dhe prespektiva e karrierës 14
III.4. Arsyet e largimit nga Shqipëria: faktorët shtytës dhe tërheqës 14
III.5. Burimet e informacionit për migrimin në Gjermani 16
III.6.Organizimi i udhëtimit 17
III.7. A kishin ndonjë plan kur arritën në Gjermani? 18

IV. ÇFARË BËNË ATA NË GJERMANI 20
IV.1. Jeta në kamp 20
IV.2. Aktivitetet e përditshme 21
IV.3. Arsimi dhe aftësitë e fituara 21
IV.4. Networku 22
IV.5. Aksesi në shërbimet sociale 23
IV.6. Njohja me gjermanët 23
IV.7. Çfarë pëlqyen në Gjermani 24
IV.8. Mësimet e nxjerra 25

V. KTHIMI NË SHQIPËRI 26
V.1. Shumica u kthyen vetë pas refuzimit të kërkesës për azil 26
V.2. Re-integrimi në sistem në Shqipëri 26
V.3. Dëshira për migrim ngelet po aq e fortë si më parë… 27
V.4. … Por .. nëpërmjet procedurave të duhura 28
V.5. Akoma ka probleme me informacionin, ... por shumë më pak së më parë 28
V.6. Migrimi i paligjshëm vazhdon të ekzistojë 29
V.7. A i njohin ata kushtet dhe procedurat për migrimin e ligjshëm? 29

VI. KONTEKSTI INSTITUCIONAL DHE LIGJOR MBI RI-INTEGRIMIN 31
VI.1. Një e treta e popullsisë shqiptare është larguar nga vendi që nga viti 1991 31
VI.2. Fenomeni i kthimit 31
VI.3. Konteksti institucional 31
VI.4. Konteksti ligjor 32
VI.5. Politikat, Strategjitë dhe Planet e Veprimit 32

VII. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET PËR POLITIKAT PUBLIKE 35

BIBLIOGRAFIA 37

SHTOJCA 38

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vala e migrimit të 2014 dhe 2015 shquhet për "normalitetin" e saj. Në qoftë se në valët e mëparshme të migrimit, të largoheshe nga Shqipëria dhe të kërkoje azil jashtë vendit ishte shumë e rrezikshme, sot kjo përpjekje planifikohet pothuajse si një udhëtim "normal". Kostot janë të paktën 10 herë më të ulëta se më parë, dhe koha e përgatitjes varion mesatarisht nga dy deri në tre ditë.

Natyra e nxitjes për t'u larguar nga vendi është e vështirë që të identifikohet me saktësi: ajo është një kombinim faktorësh, ku shumica e tyre kanë të bëjnë me kushtet socio-ekonomike (dhe çuditërisht me sigurinë fizike). Por shkaku themelor mbetet kërkimi i një mjedisi më të përshtatshëm, që do t'u ofronte mundësitë për një të ardhme më të mirë për ata dhe fëmijët e tyre.

Gjermania u përzgjodh për shkak të avantazheve të saj krahasuese në faktorët tërheqës: një sistem i organizuar mikpritës dhe përfitime bujare me para në dorë, derisa kërkesa për azil të procedohet. Një karakteristikë edhe më interesante është reputacioni i të qënit një vend që ofron mundësi më të mira jetese, i cili është serioz dhe i strukturuar rreth këtij objektivi. Italia dhe Greqia ishin relativisht më të "lehta" për t'u arritur, por ato nuk ofronin atë lloj "të ardhme" që mundëson Gjermania.

Efekti i shokut të krizës financiare të vitit 2008 shërbeu si shtysë për "materializimin" e vendimit për të emigruar. Faktorët e zakonshëm shtytës (problemet ekonomike, varfëria, strehimi dhe papunësia) përbëjnë thelbin e tendencës së kërkimit të një jete më të mirë. Për më tepër, rënia e remitancave, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, si dhe kthimi i dhjetëra mijëra emigrantëve nga Greqia dhe Italia ndihmoi që presioni migrues të arrijë pikën kthesë.

Informacioni i pjesshëm nga mediat tradicionale dhe ai i njëanshëm nga mediat sociale, presioni i të njohurve dhe transmetimi verbal jo-zyrtar i informacionit krijuan përshtypjen e gabuar tek migrantët e ardhshëm dhe rritën pritshmëritë e tyre. Trafikantët e qenieve njerëzore - edhe pse në numër shumë më të reduktuar në krahasim me dekadat e kaluara - kanë luajtur rolin e tyre. Duhet theksuar se lëvizja e lirë pa viza ishte faktori kyç që dëmtoi modelin e biznesit të këtyre trafikantëve.

Alokimet financiare të vendit pritës dhe mbështetja jomateriale (ushqim, strehim, kujdes shëndetësor) ishin një faktor shumë i rëndësishëm tërheqës. Ai i lejonte azilkërkuesve të merrnin para në dorë (të nevojshme për të paguar borxhet që ata kishin akumuluar për të financuar udhëtimin e tyre) dhe të shijonin kushtet relativisht të mira të jetesës, në disa raste më të mira se ato që kishin lënë prapa në Shqipëri. Ardhja e sirianëve i dha fund kësaj kohe pritjeje relativisht ngushëlluese.

Diaspora shqiptare ka luajtur një rol lehtësues, duke krijuar një "urë lidhëse" dhe duke ofruar një pikë të parë kontakti në Gjermani jashtë sistemit zyrtar. Përmes tejkalimit të pengesave gjuhësore, ata i siguruan migrantëve një burim të dobishëm informacioni në lidhje me jetën në Gjermani, mundësitë e punësimit, këshilla të ndryshme etj. Në thelb, ata ofruan një kanal të vlefshëm alternativ të informacionit për migrantët duke e përshtatur atë me profilin e tyre.

Migrantët ishin të papërgatitur për të qëndruar në Gjermani, qoftë për punë apo për të studiuar. Të intervistuarit nuk kishin sjellë me vete ndonjë diplomë, certifikatë ose dokument tjetër zyrtar që mund të vërtetonte kualifikimet apo aftësitë e tyre. Asnjë kërkim për punë nuk u krye paraprakisht përpara migrimit, madje,ata nuk kishin marrë as edhe një premtim të tillë. Ishte e habitshme padija e tyre mbi ligjet vendase ose kontekstin institucional gjerman. Përpos kësaj, ata nuk kishin ndonjë njohuri të gjuhës gjermane.

Niveli tronditës i lartpërmendur mbi papërgatitjen dhe pritshmëritë e larta përbëjnë arsyet kryesore të etiketimit të periudhës së pritjes nëpër kampe si një eksperiencë e "keqe". Kjo përvojë u përkeqësua më tej pas fluksit sirian. Konteksti i kampit, procedurat strikte për t'u respektuar, pamundësia për të gjetur një punë dhe realiteti në tokën e tyre të ëndrrave ishin mjaft të ndryshme nga sa pritej. Ana pozitive e kësaj përvoje është se migrantët shqiptare tani janë duke transmetuar mesazhin e duhur tek bashkëkombasit e tyre lidhur me kërkesën për azil në Gjermani.

Gjatë qëndrimit, përfitimi kryesor, përveç atij material, ishte eksperienca personale për të provuar se si funksionon sistemi gjerman. Shumë pak të rritur morën pjesë në kurse të gjuhës gjermane, patën një përvojë punësimi ose u njohën me vendasit. Ana pozitive është - përsëri - krijimi i vetëdijes se "si funksionojnë gjërat në Gjermani" dhe si duhet të jetë Shqipëria.

Në përgjithësi, emigrantëve ju pëlqente rregullsia e sistemit gjerman, por nuk parapapëlqenin përpjekjet që duhet të bënin për të qenë pjesë e tij. Megjithatë, sa më gjatë qëndronin në kontakt me vendasit, aq më shumë përfshiheshin në sistem. Tanimë në Shqipëri, ata kanë disa parametra se si ta mbajnë administratën Shqiptare të përgjegjshme.

Pas kthimit të tyre, ata vazhduan rutinën si më parë. Me përjashtim të disa personave që shitën çdogjë përpara se të niseshin në Gjermani (përfshirë shtëpinë), pothuajse asgjë tjetër nuk ka ndryshuar për ta. Nuk kanë vendosur asnjë kontakt me autoritetet shqiptare për të raportuar kthimin ose të informohen rreth masave ekzistuesepër ri-integrimin e tyre. Mësuesit nëpër shkolla kanë raportuar vështirësi për ri-integrimin e fëmijëve në kurrikulën shkollore. Shumë prej tyre- veçanërisht të rinjtë - tani janë regjistruar në kurse të gjuhës gjermane, trajnime të AFP-së (Arsimi dhe Formimi Profesional), ose janë duke përdorur kontaktet e tyre në Gjermani për të kërkuar punë. Për ata, periudha e dëbimit nga zona Schengen, do të shërbejë për t'u përgatitur më mirë për herën tjetër kur planifikojnë të shkojnë në Gjermani.

Aktualisht ndryshimi më i madh, krahasuar me përvojën e tyre të parë të migrimit, është se ata e dinë çfarë i pret dhe si të përgatiten. Megjithatë, sfida për të dy administratat, shqiptare dhe gjermane, është të arrijnë t'i informojnë, t'i përgatisin dhe t'i shoqërojnë ata në përpjekjet e tyre të migrimit. Do të ishte e pamjaftueshme që përpjekjet e qeverisë të kufizoheshin vetëm tek prodhim i iinformacionevembi rregullat dhe procedurat e migrimit të ligjshëm dhe transmetimi i tyre përmes kanaleve zyrtare.

Dalja nga një regjim gjysëm shekullor komunist dhe zhvillimi i një konteksti të përhershëm reformimi që zgjat prej 25 vitesh, i ka lodhur shqiptarët nga administrata. Ajo është parë historikisht si burim i problemeve dhe jo si një mekanizëm në dispozicion të tyre. Autoritetet duhet të marrin në konsideratë mënyra jo-ortodokse për të arritur grupet e synuara si p.sh. Mediat sociale, ish emigrantët, OJQ-të në nivel vendor, si dhe të skicojnë mesazhin në një mënyrë sa më të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë.

Këtë herë përpjekja e migrimit duhet të jetë krejt ndryshe dhe sa më pozitive për migrantët, Shqipërinë dhe Gjermaninë. Të kthyerit duhet të konsiderohen si aleatë dhe partnerë në transmetimin e mesazhit të duhur dhe të japin një shembull të mirë për t'u ndjekur.

Ky lloj fluksi migrator pritet të vazhdojë. Struktura ekonomike shqiptare nuk do të jetë në gjendje për të siguruar kërkesën e nevojshme për fuqi punëtore. Rritja e parashikuar ekonomike dhe përbërja aktuale e sektorëve dhe shërbimeve industriale, masa e popullsisë që jeton në zonat rurale, epërsia e mikro-ndërmarrjeve (nëntë nga dhjetë kompani të regjistruara në Shqipëri kanë deri në katër punonjës), nuk mund të sigurojë fuqinë tërheqëse të domosdoshme në tregun e punës.

Shqiptarët do të vazhdojnë të lëvizin jashtë vendit. Politikëbërësit nuk duhet të kenë si objektiv ndalimin e kësaj dukurie, por rregullimin dhe menaxhimin e saj. Për të zbutur ndikimin e tij negativ në Shqipëri (ikja e trurit, emigrimi i fuqisë punëtore të kualifikuar) dhe në Gjermani (sistemi i

mbingarkuar i azilit), duhet të pranohet ky fakt dhe të hartohen masat e duhura. Më e rëndësishme dhe urgjente është informimi i duhur në Shqipëri për rrugën e drejtë për të gjetur një punë apo për të studiuar jashtë vendit. Në nivelin e politikave do të ishte më pak e kushtueshme dhe më produktive nëse ata i konsideron si punëkërkues dhe / ose studentë dhe jo si "emigrantë".

Ky ndryshim drejt "rregullimit dhe normalizimit" të lëvizjes së njerëzve do të kërkonte rivlerësimin e qasjes duke zhvendosur fokusin nga menaxhimi i migrimittek masat aktive të tregut të punës. Mbi të gjitha, migrimi i rregullt i fuqisë punëtore në Gjermani nga Ballkani Perëndimor (përveç Shqipërisë) ka qenë historikisht një komponent i rëndësishëm i tregut gjerman të punës deri në vitet 1990. I menaxhuar siç duhet, ai ka qenë i dobishëm si për vendet dërguese ashtu dhe ato pritëse.

I. KONTEKSTI

Statistikat e Migrimit. Viti 2014 dhe fillimi i vitit 2015 kanë shënuar kulmin e numrit të emigrantëve dhe azilkërkuesve shqiptarë në Gjermani. Në veçanti, numri i të rinjve në këtë fluks ishte i lartë. Të dhënat e Eurostat tregojnë se 53,805 shqiptarë kanë paraqitur kërkesë për azil në Gjermani në vitin 2015, prej të cilëve 24.390 apo rreth 45% i përkasin grupmoshës 18 - 34 vjeç, 3.130 ose 5.8% ishin 14 - 17 vjeç dhe 32.410 (60%) ishin meshkuj (EUROSTAT, 2016[1]).

Pas përfshirjes së Shqipërisë në listën e vendeve të sigurta të origjinës në Gjermani në vitin 2015 dhe shtimit të riatdhesimit dhe kthimit të detyruar, vënies në praktikë të fushatave të mëdha të informimit, si dhe rritjes së përpjekjeve të autoriteteve shqiptare për të frenuar fluksin, lëvizja u qetësua disi. Nga 23,300 vendime përfundimtare që autoritetet gjermane ndërmorën për azilkërkuesit shqiptarë në vitin 2015, vetëm 55 vendime ishin pozitive. Pas refuzimit, rreth 16,000 azilkërkues u kthyen në Shqipëri në vitin 2015 duke ndjekur urdhrin e largimit (Eurostat, 2016[2]) dhe shumë të tjerë u kthyen gjatë vitit 2016. Të dhënat nuk janë të plota për shkak të vështirësive që ndeshën autoritetet shqiptare në regjistrimin e të gjithë të kthyerve të detyruar.

Faktorët shtytës dhe tërheqës. Një analizë e trendeve të faktorëve shtytës dhe tërheqës të azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor, e kryer nga Zyra Europiane për Mbështetjen e Azilit (2015)[3], arrin në përfundimin se aplikimet familjare mbizotërojnë në kërkesat për azil të shqiptarëve. Aplikuesit janë në përgjithësi femra dhe meshkuj të rinj - shpesh të shoqëruar nga familjet e tyre. Duke pranuar Gjermaninë si vendin kryesor të destinacionit të tyre, raporti jep prova se një përqindje e konsiderueshme ka qëndruar atje për më shumë se gjashtë muaj. Edhe pse ekzistojnë dëshmi anekdotike se kushtet ekonomike përbënin arsyen kryesore të fluksit migrator të kohëve të fundit, asnjë hulumtim i hollësishëm nuk është zhvilluar mbi faktorët shtytës dhe tërheqës që shkaktuan këtë vërshim mbresëlënës.

Ndërsa aktiviteti i gjenerimit "të lehtë" të të ardhurave thjesht duke shkuar në Gjermani me një vizë turistike dhe aplikimi për azil nuk është më i mundur për shkak të ndryshimit të ligjit, perspektivat e të rinjve në Shqipëri për një punë më të mirë, punësim të qëndrueshëm, të ardhura, cilësi të arsimit të orientuar drejt tregut, shërbimet e përballueshme të kujdesit shëndetësor, etj, nuk kanë ndryshuar shumë që kur ata u larguan. Kjo situatë i shtyn të rinjtë e kthyer shqiptarë të mbajnë gjallë planin për të shkuar përsëri në Gjermani. Edhe pse ekzistojnë raste të ri-emigrimit, nuk ka akoma të dhëna të disponueshme.

Trendet ekonomike aktuale. Në vitin 2015 shqiptarët përjetuan nivele të ulëta të mirëqenies dhe më shumë varfëri, ndërkohë që nuk priten ndryshime të mëdha në vitin aktual[4]. Sipas Bankës së Shqipërisë, në vitin 2015 numri i familjeve huamarrëse është rritur në krahasim me vitin 2014. Qëllimi i huamarrjes së ekonomive familjare është përdorur për financimin e borxhit të konsumit që i detyrohen dyqaneve të lagjes (39%), për biznes (15%), për riparim ose blerje banese/apartamenti (24%). Më shumë se 61% e huamarrjes familjare vjen nga burime informale (jo-bankare).

Në Raportin e Stabilitetit Financiar (2016), Banka e Shqipërisë njofton se aftësia paguese e familjeve shqiptare është përkeqësuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015 (33% e familjeve huamarrëse). 43% e huamarrësve deklarojnë se kanë vështirësi në pagimin e kredive për shkak të të ardhurave të ulëta, ndërsa 41% për shkak të kostove të larta të jetesës. Në lidhje

1 Shiko Tabelën Nr. 1.
2 http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eirtn&lang=en
3 https:// easo.europa www..eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans_Update_r.pdf
4 Raporti i Stabilitetit Financiar për Gjashtëmujorin e Dytë të Vitit 2015, Banka e Shqipërisë, 2016

me pritshmëritë për aftësinë paguese të vitit 2016, rreth 77% nuk presin ndonjë ndryshim. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2016, kreditë e papaguara u zvogëluan dhe struktura u zhvendos drejt huamarrjes formale, por huamarrja për konsum u rrit në 42%[5].

Nuk ka asnjë ndryshim të dukshëm me gjendjen e viteve të kaluara.

[5] Investing Back Home: Return Migration and Business Ownership in Albania, Talip Kilic & alii, Policy Research Working Paper 4366, The World Bank, 2007

II. OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA

II.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky studim cilësor synon të hedhë dritë mbi këtë fenomen social për të kuptuar më thellë përse dhe si shqiptarët migruan në të tilla shifra në vitin 2014 dhe 2015. Qëllimi i këtij studimi është hulumtimi dhe sigurimi i një kuptimi më të qëndrueshëm dhe të plotë mbi valën e fundit migratore, faktorët shtytës dhe tërheqës që e shkaktuan atë, përvojën e migrantëve jashtë vendit, profilet dhe perspektivat e të kthyerve. Edhe pse institucione të ndryshme kanë pasur në fokus sigurimin e statistikave mbi valën e fundit migratore nga Shqipëria dhe karakteristikat e saj, në dijeninë tonë nuk është kryer asnjë vlerësim mbi faktorët ndikues, përvojat e migrantëve jashtë vendit dhe synimet e tyre për të ardhmen e afërt, veçanërisht pas eksperiencës gjermane. Ky studim ka për qëllim të plotësojë këtë hendek duke mbetur në vetvete një punë kërkimore, një hap i parë i nevojshëm drejt një kuptimi më të plotë të problemit kërkimor.

Objektivat specifike të studimit janë:

- kuptimi i kontekstit social dhe ekonomik në të cilin migrantët jetonin, punonin dhe kryenin aktivitetet e tyre të përditshme para largimit, dhe eksplorimi i rëndësisë së tyre në vendimmarrjen për të migruar;
- kuptimi i faktorëve tërheqës dhe shtytës që nxitën ikjen në Gjermani, informacioni që dispononinin, roli i rrjeteve sociale, kostot e migracionit dhe financimit;
- kuptimi i përvojës së tyre në kampet dhe banesat sociale në Gjermani, kushtet e jetesës, rrjetet e përdorura, arsimi dhe aftësitë e fituara dhe analiza më të thella të mësimeve të nxjerra;
- kuptimi i përvojës e tyre në Shqipëri pas kthimit, identifikimi i ndikimeve sistematike që shkaktojnë dëshirën e tyre për të ri-emigruar dhe cilat mënyra synojnë të përdorin.

Përsa i përket gjetjeve, studimi propozon rekomandime se si një valë e dytë e mundshme ri-emigrimi mund të menaxhohet më me efikasitet përmes një rruge ligjore, të planifikohet dhe të jetë e vlefshme për vetë emigrantin, vendin e origjinës dhe vendin pritës.

II.2. Qasja metodologjike

Ekipi hulumtues vendosi të përdorë intervistën si një mjet për mbledhjen e të dhënave cilësore. Një grup pyetjesh të detajuara u përgatitën për të kthyerit që kishin migruar në Gjermani gjatë dy viteve të fundit dhe që mendojnë të kthehen përsëri atje. Një tjetër grup pyetjesh i drejtohet palëve të interesuara / zyrtarëve që merren me praktikat aktuale (të mira) dhe politikat e mundshme në të ardhmen. Kampioni i individëve të përzgjedhur për intervistat u identifikua përmes mediave sociale në fazën e parë dhe më tej përmes metodës së ortekut *(snowball sampling)*. Në fazën e parë, përzgjedhja e të rinjve të kthyer përdoret si një filtër i parë për të identifikuar qëllimin e tyre për të ri-emigruar, dhe nga grupi i pjesëmarrësve të mundshëm ekipi bëri përzgjedhjen e fazës së dytë në bazë të moshës, rajonit, vendndodhjes urbane/rurale, gjinisë, statusit familjar dhe statusit të punësimit.

Ekipi hulumtues ka zhvilluar intervistat dhe ka analizuar të dhënat në mënyrë rigoroze për të adresuar më mirë të gjitha pyetjet kërkimore. Rezultati i synuar ishte paraqitja e një tabloje të plotë, të qartë dhe përfaqësuese të fenomenit të fundit migrator në Gjermani, duke u fokusuar në profilin dhe përvojën aktuale të të kthyerve në Shqipëri. Ndërsa ekipi ishte i kufizuar në përzgjedhjen e një sërë metodave për kryerjen e kërkimit, ai përdori ekspertizën e studiuesve nga shkencat sociale, politike dhe ekonomike për t'i siguruar një kuptim më të gjërë nga perspektiva të ndryshme, për të përforcuar besimin në formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të duhura për politikën.

III. PROFILI I EMIGRANTIT: LARGIMI NGA SHQIPËRIA PËR HERË TË PARË

Faktorët kryesorë shtytës që pjesëmarrësit theksuan ishin: (i) problemet ekonomike; (Ii) kushtet e strehimit; dhe (iii) papunësia dhe perspektivat më të mira për karrierën. Ato ndiqen nga konflikte me familje të tjera (hakmarrje/gjakmarrje); perspektiva më të mira për jetën; largimi prej diskriminimit (në këtë rast i intervistuari ishte nga komuniteti rom), si dhe madje nga aventurat. Në asnjë rast nuk ishte kurrë vetëm një faktor që përcaktoi vendimin e tyre për të migruar - gjithmonë ka pasur shumë të tillë.

III.1. Profili demografik dhe social

Shumica e të intervistuarve ishin meshkuj[6], të moshës 20 – 34 vjeç. Disa prej të intervistuarve kishin emigruar me familjet e tyre, kryesisht me të dashurën / të fejuarën / gratë apo fëmijët. Në rastet kur migronin me partnere, të intervistuarit - kryesisht meshkuj - ndanin pikëpamjet e partnereve të tyre (femra). Pjesëmarrësit jetojnë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Fier. Koha që ata kaluan në Gjermani varion nga një minimum prej 2.5 muajsh dhe arrin deri në 2.5 vjet. Megjithatë, shumica e tyre qëndroi atje për një periudhë mesatare prej një viti, një gjetje që është në përputhje edhe me atë të Zyrës Europiane për Mbështetjen e Azilit (2015). Ata që kanë qëndruar për periudha më të gjata gjejnë një përfaqësim të konsiderueshëm në modelin tonë. Në fazën e intervistimit, shumica e tyre kishte më shumë se 9 muaj që ishte kthyer nga Gjermania, d.m.th përpara muajit janar 2016.

Migrantët e rinj meshkuj u larguan vetëm ose me miqtë. Çiftet e qëndrueshme (të fejuarit ose ata që gjendeshin në një marrëdhënie të gjatë) u larguan me partnerët përkatës. Kryefamiljarët migruan së bashku me familjarët e tyre. Kjo karakteristikë e valëve të fundit të migrimit është konfirmuar edhe nga studimet e mëparshme (Zyra Europiane për Mbështetjen e Azilit, 2015).

Në këtë pikë, një nga tiparet që shfaqet është “normaliteti” i një nisme të tillë. Në thelb, vendimi për të migruar dhe paraqitja e kërkesës për azil është marrë në forumet familjare. Ndryshe nga valët e mëparshme, këtu nuk u larguan vetëm meshkujt, por e gjithë familja, përfshirë gruan dhe fëmijët.

III.2. Arsimi dhe aftësitë profesionale

Të intervistuarit kishin nivele të ndryshme arsimore dhe ne nuk ishim në gjendje të dallonim nivelin. Shumica e të intervistuarve kishin një diplomë të shkollës së mesme në kohën kur migruan. Vetëm disa prej tyre nuk kishin diplomë ose kishin vetëm atë të arsimit fillor/ nëntëvjeçar. Dy kishin përfunduar studimet master, ndërsa tre ishin studentë në universitet dhe kishin ndërprerë studimet e tyre në kërkim të një karriere më të mirë. Ata që kishin filluar apo përfunduar studimet universitare, zotëronin njohuri të disa gjuhëve të huaja para se të niseshin, kryesisht në anglisht dhe italisht, ndonëse asnjëri prej tyre nuk fliste gjermanisht. Ata që kishin njohuri të gjuhës angleze deklaruan se kanë ndihmuar herë pas here autoritetet gjermane me përkthime gjatë qëndrimit të tyre nëpër kampe.

Niveli i arsimit nuk është një variabël strategjik kushtëzues në kampionin tonë përsa i përket vendimit të migrimit.Të gjithë kishin të përbashkët qëllimin e një perspektive më të mirë jete, pavarësisht nga aftësitë apo niveli i tyre arsimor. Ata të gjithë besonin se Gjermania do t’ua ofronte këtë mundësi.

[6] Vetëm tre prej tyre ishin femra

III.3. Situata profesionale dhe perspektivat e karrierës

Vetëm dy prej të intervistuarve ishin të papunë para se të niseshin, ndërsa të tjerët kishin një historik punësimi, edhe pse me disa periudha kur gjendeshin me ose pa punë. Problemet kryesore të ngritura prej tyre në lidhje me punësimin para se të migronin ishin punët e paguara pak, pasiguria e kohëzgjatjes së punës, pagesa në intervale jo të rregullta, puna jashtë aftësive të tyre dhe fushat e ekspertizës, ndryshimet e shpeshta të punës, mungesa e kontratave të punës dhe e pagesës së sigurimeve shoqërore. Ata që zotëronin një diplomë universitare apo arsim profesional kishin punuar në fusha të ndryshme nga specializimet e tyre, si kamerierë apo shoferë kamionësh. Të tjerë pohuan se kishin punuar në biznese të vogla familjare ose personale. Përtej faktit se shumë prej tyre kishin pasur një punë para largimit, ata të gjithë renditën kushtet e punësimit si një ndër faktorët kryesorë shtytës.

Edhe në qoftë se kampioni ynë nuk është statistikisht përfaqësues, është interesante të vihet re se - përveç papunësisë - kërkimi për kushte më të mira punësimi dhe perspektivat e karrierës janë parametra shumë të rëndësishme që ndikojnë në vendimin e tyre për të emigruar për dy arsye:

- ka shumë profesionistë të kualifikuar që po largohen nga vendi. Kjo tendencë do të thellohet më tej ku sa më të kualifikuar ata do të jenë, aq më lehtë do të mund të emigrojnë. Ndërkohë që largimi jashtë vendit për një punë më të mirë është përfitim për ta (dhe vendin mikpritës), kjo paraqet një humbje të potencialit njerëzor për Shqipërinë;
- ky fluks - d.m.th lëvizja jashtë vendit në kërkim të një pune më të mirë dhe mundësive të karrierës - i korrespondon më shumë lëvizjes së lirë të personave sesa qarqeve të azilkërkuesve. Ky është një parametër që duhet të merret parasysh kur Shqipëria të fillojë negociatat për Kapitullin 2 "Lëvizja e lirë e punëtorëve".

Në valët e mëparshme të migrimit në Greqi apo Itali, "shumë familje shqiptare e perceptuan këtë fenomentë përkohshëm apo të përhershëm, si një strategji efektive për mbajtjen dhe përmirësimin e mjeteve ekonomike të jetesës[7]" në Shqipëri. Këtë herë ata e konsiderojnë migrimin me shumë si një veprim për një të ardhme më të mirë, se sa për një punë konkrete. Grupi i migrantëve që ne kemi intervistuar nuk bënin pjesë në grupin e "të varfërve të tejskajshëm", por më tepër përngjanin me profilin e qytetarit mesatar.

III.4. Arsyet e largimit nga Shqipëria: faktorët shtytës dhe tërheqës

Në përgjithësi, të rinjtë mendojnë se është pothuajse e pamundur të ndërtosh një familje të re, pa pasur të ardhura të mjaftueshme për të siguruar shpenzimet për një jetesë të mirë dhe strehim. Ata vlerësojnë se kjo aspiratë është e pamundur në Shqipëri me aq sa fitojnë momentalisht ose kanë në plan të fitojnë. Kështu që vendosin të largohen nga vendi. Papunësia, pasiguria e punës, punët e rastësishme apo punët me të ardhura të ulëta e të paktën njërit prej partnerëve, ka nxitur çiftet e martuara për t'u larguar. Kushtet e jetesës ndikojnë fuqishëm në listën e tyre të faktorëve shtytës. Një grua pohoi se familja e saj nuk jetonte në një shtëpi të mirëfilltë, sepse ata nuk mund të përballonin një të tillë.

Performanca ekonomike e Shqipërisë dhe rënia e kërkesës për punë gjatë periudhës së migrimit të tyre në Gjermani (2014-2015), ishin përcaktues të rëndësishëm mbi emigrimin, edhe për ata që kishin një profesion dhe / ose ishin duke punuar në bizneset e tyre. Një tjetër grua u shpreh: *"... Unë kam punuar si rrobaqepëse (biznes personal), dhe në atë kohë nuk kam pasur shumë punë; burri im kishte një piceri, por ai e mbylli atësepse fitimi nuk ishte i mjaftueshëm për të mbajtur fëmijët ..."* (Intervistë 1-3). Ajo gjithashtu tregoi se burri i saj i përket komunitetit rom dhe se dëgjuan që për ata do të ishte më e lehtë marrja e azilit në Gjermani.

Kërkoj një jetë më të mirë - dhe ndonjë aventurë - ky faktor ishte gjithashtu i përfshirë në vendimmarrjen për t'u larguar. *"... Qëkur isha fëmijë, ka qenë ëndrra ime të shkoja në Gjermani*

[7] Investing Back Home: Return Migration and Business Ownership in Albania, Talip Kilic & alii, Policy Research Working Paper 4366, The World Bank, 2007.

dhe të punoja atje si një mekanik për makina, pasi Gjermania është e njohur për industrinë e makinave. E dija se do të kishte mundësi punësimi në Gjermani dhe ky ishte motivimi im për të shkuar atje ... " (Intervistë 2-1).

Pas krizës financiare të vitit 2008, shumë emigrantë shqiptarë u kthyen nga Greqia dhe Italia. Një studim i kryer nga INSTAT dhe IOM (2014) vlerëson se gjatë vitit 2009 - 2013, rreth 133,544 emigrantë shqiptarë janë kthyer në Shqipëri, kurse 53.4% e tyre u kthyen gjatë vitit 2012 dhe 2013. I njëjti studim raporton se ka disa prova që tregojnë se mungesa e mundësive të ri-integrimit në Shqipëri mund të ketë shërbyer si një faktor shtytje për ri-emigrimin e të kthyerve (Filipi et al., 2014) në drejtim të vendeve të tjera të BE-së. Gjetjet nga intervistat me azilkërkuesit e kthyer gjithashtu tregojnë se ata ishin përshtatur me një mënyre jetese dhe mentaliteti të ndryshme. Ata hasën vështirësi në procesin e ri-integrimit në shoqërinë shqiptare, duke e cilësuar këtë eksperiencë si jo fort të këndshme. Për këtë arsye, ata e kanë të vështirë të imagjinojnë një të ardhme në Shqipëri dhe kjo ka vepruar si një forcë shtytje për migrimin e tyre drejt Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar apo vendeve nordike.

Siguria e jetës ishte një tjetër faktor i vlefshëm shtytje. *".... Arsyeja kryesore për të cilën u largova për në Gjermani ishte se ndihem i pasigurt në vendin tim. Në vitin 2005, vëllai im ishte i përfshirë në një konflikt me disa njerëz të tjerë, të cilët kanë qëlluar në drejtim të shtëpisë sime në mes të natës. Ne do të kishim vdekur me kohë, por patëm fat që plumbat nuk kapën asnjërin prej nesh që ndodheshim në shtëpi. Personi që na qëlloi u dënua për 10 vjet dhe tani ai ndodhet jashtë burgut. Ne ende nuk ndihemi të sigurt në shtëpinë tonë. Një tjetër arsye përse ne u larguam nga Shqipëria ishte për shkak të situatës ekonomike ..."* (Intervistë 2-3).

Të intervistuarit gjithashtu pohojnë se në kohën e migrimit, mediat luajtën një rol të rëndësishëm në vendimin e tyre. Një kërkim në Google "kritere për azil në Gjermani" në shqip[8] prodhon rreth 587,000 rezultate, një matës i mbulimit masiv të këtij fenomeni nga media. Ky fenomen u bë një diskutim i zakonshëm në media, sipas së cilave Gjermanisë i nevojitej fuqi punëtore ekstra-komunitare për shkak të uljes të numrit të lindjeve. Kjo përshtypje u përforcua nga lajmi se autoritetet gjermane do t'iu sigurojnë menjëherë migrantëve strehim dhe punë. Kjo i intrigoi ata, konfirmimi (dhe dezinformimi) nga rrjetet sociale e zmadhoi më tepër lajmin. Por, duhet theksuar se, edhe pse të gjithë pohuan se u larguan për t'u punësuar, ata nuk kishin si qëllim të qëndronin atje nën skemat e mbrojtjes sociale.

Mbi faktorët tërheqës, ka një dakordësi pothuajse të plotë, se ishte niveli i zhvillimit social-ekonomik dhe standardet e larta të jetesës së vendit të destinacionit çka i tërhoqi njerëzit: *"....ne të gjithë e dimë se Gjermania është një nga vendet më të zhvilluara në Europë dhe çdo i ri do të dëshironte të jetonte dhe të studionte atje, pasi në Shqipëri nuk e kemi atë lloj të ardhme..."* (Intervistë 1-2). Mundësi më të mëdha për t'u punësuar, punë më e mirë, të ardhura më të larta, dhe - sidomos për ata që kishin një profesion - mundësi për t'u zhvilluar profesionalisht dhe perspektiva më të mira arsimi për fëmijët e tyre ishin faktorët kryesorë tërheqës, edhe për ata që kishin aplikuar për azil dhe mbrojtje.

Kompensimi i paguar nga autoritetet gjermane për shpenzimet e jetesës gjatë periudhës së azilit ishte një faktor shumë i rëndësishëm tërheqës. Ndihma mujore ishte mesatarisht 140 euro për të rritur dhe 40 euro për fëmijë. Strehimi, energjia elektrike dhe faturat e ujit, si dhe shërbimet mjekësore ishin falas për të gjithë familjen. Premtimi i këtyre të ardhurave provokoi aspiratat e migrimit tek një pjesë e madhe e popullsisë për të paktën dy arsye kryesore. Së pari, i bënte shpenzimet e migrimit më të përballueshme për një shkallë të gjerë të popullsisë - ata mund të merrnin borxh dhe ta shlyenin atë sapo të vinte ndihma financiare nga qeveria gjermane.[9] Së dyti, nën një perspektivë me afatgjatë, të ardhurat e marra nga autoritetet gjermane (duke përfshirë strehimin, shkollimin dhe kostot shëndetësore) ishin shumë më të larta se pagesa minimale e një pune në Shqipëri. Përpunimi i kërkesave për azil në Gjermani ishte duke marrë më tepër kohë se

[8] Kërkimi në google.al me fjalët "Kushtet për azil në Gjermani"

[9] Kjo është një situatë paradoksale pasi politikat e migrimit në vendin pritës në mënyrë indirekte financojnë fluksin migrator të padëshiruar dhe të paligjshëm.

zakonisht për shkak të numrit të madh të tyre. Por në fund, pavarësisht nga vendimi i autoriteteve - pozitiv apo negativ - të ardhurat e përfituara do t'i kishin lejuar migrantët shqiptarë të përballonin jetën në kushte të mira, të merreshin me çështjet shëndetësore, madje në disa raste edhe të kursenin disa para. Dhe gjithçka sa u përmend më lart nuk përmbante ndonjë rrezik fizik.

Një tjetër faktor i rëndësishëm tërheqës ishte roli i diasporës ekzistuese të emigrantëve shqiptarë në Gjermani. Të intervistuarit kanë dhënë prova të shumta mbi informacionin që i ka shtyrë ata drejt migrimit. Shqiptarët[10] e vendosur tashmë në Gjermani kanë ndarë përvojat dhe pikëpamjet e tyre mbi migrimin dhe premtuan se migrantëve të ardhshëm do t'iu siguronin mbështetje, strehim ose do të përdornin rrjetet e tyre për t'iu gjetur punë, në qoftë se azilkërkuesve do t'iu lejohej e drejta për qëndrim dhe punësim.

Vlen të theksohet se faktorët shtytës dhe tërheqës nuk ishin përjashtues, por shpesh herë përkonin dhe justifikonin vendimin për të migruar. Por, përshtypja e përgjithshme e të intervistuarve është se në të shumtën e rasteve, vendimi u mor në bazë të informacioneve sipërfaqësore, nën ndikimin e fortë të të njohurve ose duke ndjekur thjesht fluksin dhe dukeshpresuar për një të ardhme më të mirë. Ne nuk vumë re ndonjë ndikim të dukshëm nga informacione të ardhura nga kanalet zyrtare.

III.5. Burimet e informacionit për migrimin në Gjermani

Pjesa më e madhe e të intervistuarve pohojnë se e kanë marrë informacionin se ku dhe si të migrojnë nga miqtë, anëtarët e familjes apo të afërmit, dhe në veçanti nga individë që ndodheshin tashmë jashtë vendit ose kishin përvojë të mëparshme migrimi / kërkim azili. Familjarët dhe të afërmit e tyre në Gjermani e kanë mbështetur vendimin që ata të largohen. Këto deklarata mbështesin ndikimin e fortë të efektit të shoqërisë.

Vendimi u mor në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të familjes. Kjo duhet të jetë një karakteristikë e zakonshme për ato familje që kanë migruar së bashku, si dhe për të rinjtë që vendosën të migrojnë vetëm ose me miqtë. Në rastin e të rinjve, këta të fundit janë konsultuar me familjet që e kanë mbështetur vendimin e tyre për t'u larguar. Një nga të intervistuarit tha se familja e tij e mbështeti vendimin për të migruar, duke menduar se do të aplikojnë për bashkim familjar pasi djali / vëllai i tyre të merrte lejen e qëndrimit në Gjermani dhe / ose të gjente një punë. Ai thotë: *"... Unë gjithashtu kisha dëgjuar nga shokët e tjerë se Gjermania në atë kohë kishte nevojë për fuqi punëtore. Familja ime e kuptoi situatën dhe më mbështeti për t'u larguar. Të dy prindërit erdhën pas dy muajsh. I nxita të vinin sepse kam dëgjuar se ishte më e lehtë për të marrë një përgjigje pozitive nga autoritetet, nëse do isha atje me familjen. Ata kaluan nëpër një situatë të ngjashme, por nuk ishin pranë meje, por në një kamp tjetër, 6-7 orë larg nga ku ndodhesha unë. Ata gjithashtu u kthyen në më pak se 6 muaj ..."* (Intervista 3-2).

Tre djem të rinj deklaruan se prindërit nuk e mbështetën vendimin për t'u larguar. Megjithatë, ata vendosën të largohen së bashku me miqtë e tyre. Sidoqoftë, familjet përkatëse - edhe pse nuk ishin dakord me vendimin - u siguruan atyre financimin për të udhëtuar drejt Gjermanisë.

Media vizive dhe ajo online kanë vepruar jo vetëm si një faktor shtytje, por edhe si një burim (i njëanshëm) informacioni. Një nga të intervistuarat pohon se deklarata e kancelares Merkel gjatë vizitës së saj në Tiranë, në korrik të vitit 2015 *"... Gjermania ka nevojë për fuqi punëtore."* (Merkel, 2015), ishte informacioni më i rëndësishëm ku ajo u mbështet për të vendosur për të emigruar. Media lokale kishte një efekt ekzagjerues, si p.sh. diskutimet e fokusuara në migrimin drejt Gjermanisë, që shpjegonin pengesat dhe pasojat e refuzimit të azilit. Ky kombinim i mesazheve të njëanshme apo i mungesës së tyre, i shtyu njerëzit të prodhojnë vetë "filmin e migrimit" të tyre duke mbledhur dhe duke zgjedhur informacionin që i përshtatej me shumë bindjes së tyre.

[10] Përfshin shqiptarët etnikë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia etj.

Komunikimi përmes Facebook-ut, dhe të tjera teknologji të internetit ishin mjaft të rëndësishme për të marrë informacion dhe / ose udhëzime për migrantët e ardhshëm, veçanërisht të rinjtë. Me anë të Facebook-ut ata do të hidhnin vështrimin e parë - që nuk është gjithmonë "i vërteti" - përçka i priste në Gjermani. Por, siç u përmend më parë, ky informacion ka qenë shumicën e kohës i njëanshëm, pasi migrantët shqiptarë tashmë në Gjermani kërkonin që të portretizoheshin si të suksesshëm në vendin e tyre. Kjo shpjegon habinë e migrantëve shqiptarë sapo u vendosën nëpër kampe, ose mungesën e tyre të plotë të përgatitjes sa i përket çështjeve administrative / dokumentave.

Shpenzimet e udhëtimit nga Shqipëria në Gjermani janë mbuluar nga vetë personat ose përmes financimit / familjar, që varionte nga 170 deri në 700 euro për person, në bazë të mjetit të transportit që zgjidhej. Ata kanë marrë ndihma javore nga institucionet gjermane për aq kohë sa qëndruan atje. Disa prej tyre i paguan vetë biletat e kthimit. Mesatarisht, kjo sipërmarrje migrimi ka një kosto rreth 1,000 euro për person.

Asnjë nga të intervistuarit tanë nuk ka kërkuar informacione në institucionet e specializuara zyrtare, qofshin këto Sportelet e Migracionit apo Ambasada Gjermane. Kjo korrespondon me përqindjen e ulët të migrantëve të ardhshëm që përdorin ose kanë njohuri mbi këto burime zyrtare. Mënyra për të sfiduar rrugën e jashtëligjshme është promovimi i burimeve zyrtare dhe / ose përdorimi i kanaleve ekzistuese - familjes, miqve, Facebook-ut, etj - për të dhënë informacionin e duhur.

Informacioni është konsideruar si një nga faktorët kryesorë që ndikon në migrim. Në vitin 2016 në Shqipëri filloi zbatimin projekti DIMAK (një projekt i GIZ, - i zbatuar dhe financuar nga Qeveria Gjermane). Ky projekt ka për qëllim të informojë qytetarët shqiptarë që duan të emigrojnë në Gjermani dhe t'iu mundësojë atyre informacion në lidhje me procedurat ligjore. Përveç kësaj, qeveria shqiptare ka ngritur sportelet e Migrimit (pranë ambjenteve të Zyrave të Shërbimit Kombëtar të Punësimit). Kompanitë private të rekrutimit gjithashtu kanë intensifikuar komunikimin e tyre.

III.6. Organizimi i udhëtimit

Nuk kishte asnjë planifikim të mirëfilltë. Pasi u mor vendimi, hapi tjetër më i rëndësishëm ishte zgjedhja e mjetit të transportit. Kjo kushtëzohej nga kostoja dhe lehtësia e të udhëtuarit nëpërmjet kufijve, duke shmangur ato problematikë[11]. Si gjithmonë, pika e referencës ishin rastet e mëparshme të "suksesshme". Disa prej të rinjve të anketuar, meshkuj, thanë se ata vetëm donin të provonin ashtu siç kishin bërë dhe njerëzit e tjerë. Është interesante të theksohet se zakonisht vendimi për të migruar në Gjermani u morr në një kohë shumë të shkurtër. Pothuajse të gjitha planet për udhëtim janë bërë në më pak se një javë, zakonisht në 2 ose 3 ditë. Kjo nuk lë kohë për përgatitjen e duhur, për të sistemuar dokumenta të ndryshme zyrtare, çertifikata të gjendjes civile apo diploma, etj, - të gjitha këto mëse të nevojshme për të filluar një jetë të re në Gjermani[12]. Vetëm një i intervistuar, i cili kishte emigruar me familjen e tij, deklaroi se e pati planifikuar të gjithë migrimin brenda një periudhe dyjavore. *"... Unë nuk e mendoja shumë faktin nëse do të shkoja apo jo, kam diskutuar me familjen time dhe ata ranë dakord. Dhe pas 2-3 ditësh, një nga të afërmit tanë na tha se si të shkonim dhe çfarë të bëjmë dhe ne vendosëm të iknim me autobus. Kam dëgjuar se duke kaluar kufirin ishte më e lehtë me autobus dhe se nga aeroportet ishte më e vështirë, kjo për shkak të kontrolleve të shumta dhe kërkesave të ndryshme ... (Intervista 1-1)"*

Janë përdorur të gjitha mjetet e transportit: nga ato detare, trageti për në Itali dhe pastaj vazhdimi me tren, autobus apo furgon në Gjermani, tek fluturimet direkt nga Tirana në aeroportet gjermane

[11] Për shembull, kufiri kroat shmangej rreptësisht.

[12] Do të kishte qënë fakt interesant marrja e informacionit mbi dokumentat zyrtare që emigrantët shqiptarë u paraqisnin autoriteteve gjermane. Ky do të ishte një tregues i mirë, jo vetëm për shkallën e tyre të përgatitjes mbi procesin e migrimit, por edhe për mentalitetin në lidhje me rëndësinë e procedurave në përgjithësi.

përmes udhëtimit ajror. Është me rëndësi të përmendet se nuk ka pasur kalim të paligjshëm të kufijve[13]. Informacioni në lidhje me mënyrat e lira dhe të sigurta për të arritur në Gjermani ndahej midis midis atyre që arritën për herë të parë dhe atyre që e kishin planifikuar udhëtimin më vonë. Individët nga zonat jugore të vendit, gjetën mënyra për të udhëtuar përmes Greqisë, duke shmangur kontrollet e rrepta të policisë dhe marrjen në pyetje, gjithashtu ulën shpenzimet e udhëtimit me avion, duke përdorur transportin me kosto më të lirë.

Asnjë prej tyre nuk ka raportuar ndonjë problem gjatë udhëtimit. Ata shkuan nëpër të gjitha pikat e rregullta të kalimit kufitar. Pasi arritën në Gjermani, miqtë e tyre ishin duke i pritur për t'i shoqëruar nëpër kampe, ose ata thjesht ndoqën fluksin e migrantëve të tjerë, ose u gjendën nën mbikëqyrjen e policisë dhe u dërguan nëpër kampe.

Në përgjithësi, udhëtimi nga Shqipëria në Gjermani ka qenë pak a shumë pa incidente. Asnjë nga të intervistuarit tanë nuk raportoi probleme gjatë udhëtimit. Asnjë prej tyre nuk parashikonte të ndalonte në ndonjë nga vendet e BE-së ku ata kaluan.

III.7. A kishin ndonjë plan kur arritën në Gjermani?

Migrimi nga Shqipëria, veçanërisht fluksi në Greqinë fqinje, ka qenë tradicionalisht i karakterizuar nga një natyrë e përkohshme, qoftë sezonale ose qarkulluese[14]. Këtë herë ata zgjodhën Gjermaninë për t'u vendosur atje. Të gjithë të intervistuarit e kishin planifikuar Gjermaninë si destinacionin e tyre të fundit dhe të vetëm, duke hequr dorë nga çdo alternativë në vendet e tjera ku udhëtuan. Pasi arritën në Gjermani, hapi i rradhës ishte kontaktimi i zyrtarëve gjermanë dhe paraqitja e kërkesës së tyre për azil, pas kësaj ata nuk kishin një plan të vërtetë, përveçse "prit-dhe-shiko". Ata që zgjodhën për të aplikuar për azil janë regjistruar përmes një procesi intervistimi (me përkthyes të gjuhëve shqipe dhe gjermane, pasi asnjë prej të intervistuarve nuk kishte njohuri të gjermanishtes) dhe pastaj u vendosën në kamp.

Kjo është deklaruar në mënyrë të qartë nga të gjithë të intervistuarit, se ata kurrë nuk e kishin planifikuar, synuar apo pritur që të qëndronin në kamp. Ata e panë këtë si një hap të ndërmjetëm para se të lëviznin drejt një strehimi të mirëfilltë - si shokët e tyre shqiptarë që kishin migruar më parë dhe i kishin treguar - dhe punësimit. Në shumicën e rasteve, kërkimi për punë iu ishte referuar në mënyrë të qartë autoriteteve të kampit si shtysa kryesore e migrimit. Në skemën e tyre mendore, ata ishin të bindur se Gjermania do t'i mirëpriste dhe mënyra më e shpejtë dhe më e lehtë do të ishte përmes procedurës së kërkesës për azil. Pra, ata thjesht shprehën - gjatë procedurës së tyre të kërkesës për azil - nevojën për të gjetur një punë.

Edhe pse plani fillestar ishte për të aplikuar për azil, pas pajisjes me mjetet themelore dhe qëndrimit të ligjshëm (gjatë periudhës së procedurës së azilit), ata menduan se punësimi mund të jetë një mundësi për të qenë aktivë, të njohin Gjermaninë dhe gjithashtu të sigurojnë të ardhura shtesë. Disa prej tyre kontaktuan dhe u ndihmuan në kërkimin e tyre të punës prej migrantëve shqiptarë që jetojnë ligjërisht në Gjermani. Mungesa e njohurive të gjuhës gjermane, njohjes së sistemit administrativ gjerman, tregut të punës dhe rregullave te tij, mungesa e informacionit se si të jetohet dhe punohet në Gjermani në mënyrë të ligjshme (pavarësisht nga broshurat e shpërndara nëpër kampe) mbizotëruan gjatë kësaj periudhe të ekspozimit të tyre. Është i habitshëm niveli i mosinformimit mbi rregullat gjermane të punësimit. Për shembull, ata nuk ishin të vetëdijshëm se, nuk ishte e rëndësishme të gjeje një punëdhënës që mund të ofronte një punë, por punëdhënësi duhet të sigurohej më parë se asnjë qytetar gjerman apo nga Bashkimi Europian nuk është i gatshëm apo i predispozuar për të aplikuar në atë pozicion vakant. Një nga të intervistuarit pohoi: *"... Unë kisha një kushëri në Gjermani i cili doli garant*

[13] Fill pas vendosjes së lëvizjes së lirë, shqiptarët zotërojnë një pasaportë të vlefshme dhe nuk kanë nevojë për vizë në rast udhëtimi/vizite në vendet Schengen.

[14] Investing Back Home: Return Migration and Business Ownership in Albania, Talip Kilic & alii, Policy Research Working Paper 4366, The World Bank, 2007.

për mua dhe më ofroi një punë. Në të njëjtën ditë, kur unë mora përgjigjen pozitive, vetëm 10 orë më vonë, erdhi policia për të më dëbuar ..." (Intervistë 3-1).

Pas përballjes me realitetin nëpër kampe dhe në shtëpitë e emigrantëve ku ata caktoheshin në Gjermani, situatës atje, përfshirë dhe fluksin masiv të refugjatëve sirianë,disa prej të anketuarve të rinj deklaruan se ata kanë filluar të planifikojnë të lëvizin në Suedi apo Norvegji[15].

[15] Ata intervistues që u njoftuan nga administrata gjermane mbi refuzimin e aplikimit të azilit, u deportuan në Shqipëri përpara se të provonin fatin e tyre në vendet nordike.

IV. ÇFARË BËNË ATA NË GJERMANI?

Vendndodhja e tyre dhe përvoja individuale me strehimin në Gjermani është mjaft heterogjene, por askujt nuk i pëlqente kampi. Individët që intervistuam kanë qenë në rajone të ndryshme si Shtutgart, Rothenburg, Ladenburg, Bad Urah, Lubenau, Horvailer, Albstadt, Frankfurt, Babenhausen, Mynih, Dresden, Hamburg, Berlin, Dortmund, Dyseldorf, Esen, etj.

IV.1. Jeta në kamp

Në mënyrë kronologjike, ajo që është mjaft e zakonshme në përvojat e tyre është qëndrimi fillimisht në kampe refugjatësh, për periudha të ndryshme nga disa ditë deri në një muaj. Atje ata janë intervistuar në lidhje me qëllimin e vizitës, arsyet përse u larguan nga Shqipëria, formimin dhe kualifikimet e tyre, si dhe janë pajisur me dokumentat përkatëse administrative. Pasi ka përfunduar procedura administrative e regjistrimit dhe intervistimit, filloi periudha e pritjes.

Sipas këndvështrimit të tyre, kushtet në kampe nuk ishin të këqija, por ishte më shumë një ngarkesë psikologjike për ta. Mënyra e re e të jetuarit, veçanërisht me azilkërkues të tjerë, përzierja e kulturave dhe kombësive të ndryshme, ndryshimi i shpeshtë i kampeve dhe llojet e tjera të kufizimeve, rrjetet e reja shoqërore, formime dhe mentalitetetë ndryshme të njerëzve rreth tyre, pengesat gjuhësore dhe kufizimet e komunikimit, peshuan fort në psikikën e tyre. *''Ne qëndruam në të njëjtin ambjent me njerëzit më të varfër nga vendet më të varfra. Kjo ishte një përvojë tronditëse për ne"* (Intervistë 6-1).

Dy nga të intervistuarit kanë raportuar se kanë jetuar në kampe të mbipopulluara, ku kushtet e përgjithshme dhe higjiena ishin jashtëzakonisht të këqija dhe situata shumë e pasigurt. Një nga të intervistuarit (3-3) pranoi se ai duhej të priste rreth një muaj për të pasur çarçafë të pastër krevati. Në qoftë se ata ishin me fat, mund të ishin lejuar për të ndarë dhomën e kampit dhe WC me miqtë e tyre ose familjet e tjera. *"... Jeta në Karlsruhe ishte si në filma. Nejetonim me kaq shumë njerëz, ka pasur vrasje[16], debate dhe zënka gjithë kohës, i vidhnin njëri-tjetrit rroba, çdogjë tjetër, çorape. Më kujtohet një herë kur një person u hodh nga dritarja dhe vdiq para këmbëve të mia[17]. Ka shumë djem shqiptarë në burg për shkak të situatave të tilla nëpër kampe. Por kjo ishte në Badenberg, kampet e tjera kanë qenë më mirë. Kur dy azilkërkues ziheshin, punonjësit e sigurisë nuk ndërhynin aspak."* (Intervistë 3-3).

Më vonë, shumica e tyre u vendosën nëpër apartamente, ku ata e menaxhuan vetë jetën e tyre. Disa prej të intervistuarve iu ishte dashur të lëviznin disa herë nga një kamp në tjetrin, para se të zhvendoseshin në një apartament. *"... Të gjitha këto transferime kanë qenë të lidhura me frikën e pasigurisë: Ku do të përfundojmë?! ..."* (Intervistë 4-2).

Ata gjithashtu raportuan se iu është dhënë një ndihmë javore prej rreth 30-35 euro gjatë qëndrimit nëpër kampe. Bashkia përkatëse gjermane i paguante atyre një kompensim mujor për ushqim, kupona dhe veshje për çdo anëtar të familjes, gjë e cila iu dukej e përshtatshme. Ata nuk u lejuan të punojnë, por tashmë këtë e dinin.

Kjo mënyrë jetese siç përshkruhet më sipër, është përmendur në shumë faqe të rrjeteve sociale të të kthyerve, komplet të ndryshëm nga të intervistuarit tanë për këtë kërkim. Duket qartë se shqiptarët ishin plotësisht të papërgatitur për atë që do i priste sapo të arrinin në Gjermani. Në vend të ndihmave shtetërore, një shtëpie dhe një pune, ata e gjetën veten në kampet e

[16] Ne nuk mundëm ta verifikonim këtë deklaratë në mënyrë të pavarur.
[17] Idem

tejmbushur me kombësi të tjera, duke mos ditur gjuhën dhe pa asnjë plan për hapat e ardhshëm. Ana pozitive e kësaj përvoje ishte se ky grup i migrantëve nuk pati asnjë problem për t'i treguar të vërtetën shokëve të tyre shqiptarë në lidhje me gjendjen reale "mikpritëse".

IV.2. Aktivitetet e përditshme

Aktivitetet e tyre ditore më të shpeshta gjatë periudhës së qëndrimit në Gjermani përfshinin kurse të gjuhës dhe veprimtaritë sportive. Ata gjithashtu dilnin me miqtë, vizitonin qytetin dhe vende te ndryshme, shëtisnin nëpër parqe, luanin futboll, shkonin në internet kafe ose në dyqane ushqimore për të blerë gjërat që i nevojiteshin më shumë etj. Megjithatë, ata deklaruan se shumicën e kohës e kanë kaluar pa bërë gjë. Një nga të intervistuarit nënvizoi se: *"... Shumicën e kohës kam qëndruar në apartament. Unë dilja jashtë vetëm për të marrë vajzën time në shkollë dhe dy herë në javë kur frekuentoja kursin e gjuhës gjermane. Dilja jashtë vetëm për të bërë pazar dhe për të shëtitur me fëmijët ..."* (Intervista 1-3).

Është interesante të theksohet se, ndërsa të rriturit nuk ishin entuziastë për të ndjekur kurset e gjuhës gjermane që u vunë në dispozicion të tyre nga administrata e kampit apo komunave, fëmijët e tyre ishin shumë të lumtur kur u regjistruan në sistemin shkollor. Edhe pse jo të gjithë të intervistuarit kanë marrë pjesë në kurset e gjuhës, ata që e bënë këtë, raportojnë se kjo përvojë ishte shumë e dobishme për ta. Ata që nuk u regjistruan, tani pendohen.

Disa prej tyre gjithashtu kanë kërkuar punë, edhe pse ishin të vetëdijshëm se nuk iu lejohej për të punuar. Ata vendosën kontakte kryesisht me shqiptarë që jetonin në Gjermani apo vendasit që ishin të gatshëm për t'i ndihmuar. Disa ishin edhe të suksesshëm në punë, por për një periudhë të shkurtër. Njëri prej tyre është paguar për të siguruar në kamp shërbimin e përkthimit nga anglishtja. Një tjetër tha se ai ishte i angazhuar nga koha në kohë në shërbimin e postimit të dërgesave, kurse një tjetër ishte duke punuar në afërsi të kampit si mekanik makinash për një periudhë të shkurtër. Ky i fundit theksoi se u largua për shkak se paga nuk ishte e mjaftueshme: ai ishte paguar rreth 900 euro në muaj duke qëndruar në kamp për shkak të - dhe kryesisht - mungesës së dokumentave përkatëse. Pra, nuk ia vlente rreziku për të vazhduar punën. Një nga të intervistuarit ka deklaruar se shumica e vendeve të punës janë marrë nga sirianët, sepse ata ishin të gatshëm të punonin për rroga të ulëta, duke krijuar edhe disa raste konfliktuale.

Periudha e qëndrimit nëpër kampe nuk ka sjellë asnjë vlerë shtesë as në pasuri, as në përvojën e jetës për shumicën e të intervistuarve tanë. Ata që kanë përfituar më shumë ishin fëmijët - pasi të gjithë shkuan në shkollë dhe e mësuan gjermanishten shumë shpejt. Në përgjithësi ata dolën me rezultate shumë të larta. Rrallë herë emigrantët shqiptarë arritën të punësoheshin. Disa prej tyre u punësuan si shërbyes, ad-hoc apo në punë afatshkurtra, por ky ishte një përjashtim.

IV.3. Arsimi dhe aftësitë e fituara

Përfitimi më i madh për ata që qëndruan për periudha të gjata në Gjermani, ishte mësimi i gjuhës, por jo të gjithë i ndoqën këto kurse. Të rinjtë e motivuar dolën më mirë në kurset e gjuhës; të tjerët vetëm morrën pjesë disa herë dhe pastaj hoqën dorë. Arsyet për të mos marrë pjesë, ose për të hequr dorë, janë nga më të ndryshmet. Më vonë disa prej tyre pohuan se në atë kohë ata nuk i kushtuan rëndësi - dhe se tani pendohen. Në disa raste të tjera, kurset e gjuhës ishin aq të populluara saqë ata thjesht menduan t'i anashkalonin.

Ata që patën rastin për t'u angazhuar në punë, përfituan jo vetëm në aspektin e të ardhurave shtesë dhe përfshirjes sociale, por edhe të fitimit ose përmirësimit të aftësive të reja. Një mundës profesionist, i cili migroi për të ndjekur një karrierë në sportin e mundjes, u shpreh se *"... Së pari, ata më vunë në provë për të parë nëse përmbushja standardet e caktuara të garës. Pasi i përmbusha këto standarde, brenda disa ditësh isha në gjendje të garoja në nivel vendor dhe rajonal në Gjermani. Por, nuk arrita të garoja në nivel kombëtar. Për secilën garë mora një lloj*

pagese. Unë vazhdova të merresha me mundje në Gjermani dhe përfitova diploma/certifikata, madje arrita të pozicionohesha dhe në vendet më të larta (2-4) në Hanover" (Intervista 4-1).

Me përjashtim të dukshëm të fëmijëve, koha që pjesa tjetër kaloi në Gjermani nuk ka shërbyer për të rritur kapitalin e tyre të arsimit dhe/ose potencialin e tyre tëpunësimit. Në raste të rralla, dhe ekskluzivisht pothuajse për shkak të nismës personale, individë të caktuar thyen rregullat dhe u angazhuan në aktivitete prodhuese. Kjo i lejoi ata të bashkohen me popullsinë dhe të njohin më mirë kulturën gjermane, mënyrën e jetesës dhe popullin gjerman. Kjo ishte për ta një vlerë e shtuar e vërtetë.

IV.4. Networku

Azilkerkuesit që qëndruan nëpër kampe kishin si mundësi të vetme kontaktet me shërbimet zyrtare dhe administrative në kamp. Ata kishin mjaft kohë për t'u takuar, të diskutonin dhe të ndanin përvojat e jetës me individë të kombësive të ndryshme, jo të BE-së, por ata nuk kishin pothuajse asnjë kontakt me qytetarët gjermanë.

"... Unë e kuptova çfarë dëshiroja vetëm kur u largova nga kampi. Atëherë kam gjetur vlerat dhe vendin që po kërkoja" (Intervistë 6-1). Mundësitë e përfshirjes në rrjete u rritën pasi ata u larguan nga kampet, por suksesi i tyre varej nga vullneti i migrantëve dhe aftësia për t'u angazhuar në kulturën vendase. Disa nga të intervistuarit kanë vazhduar të jetojnë në "flluskën shqiptare": ata nuk kishin kontakt fare me vendasit, as që përpiqeshin për këtë. Përveç punëve të përditshme, ata kanë përdorur kohën në dispozicion për të komunikuar me familjet e tyre, që i patën lënë pas, dhe me njerëz që ndodheshin në të njejtat rrethana, të afërm dhe miq, në të shumtën e rasteve shqiptarë. Vendet dhe ndërtesat ku azilkërkuesit kishin jetuar, ishin të ndara nga ato që përdornin vendasit, kështu që distanca fizike në këtë rast mund të quhet një faktor plus. Të gjithë të intervistuarit binin dakord se njohja e gjuhës gjermane ishte pengesa kryesore për t'u angazhuar në marrëdhëniet shoqërore.

Ata që kanë marrë pjesë në kurse të gjuhës gjermane, kanë krijuar disa rrjete jo-formale me gjermanë ose të huaj të tjerë.

Duke qenë në të njëjtën klasë dhe duke punuar drejt një qëllimi të përbashkët, ata filluan të kapërcenin pengesat kulturore dhe gjuhësore. Në disa deklarata, u duk se një nga arsyet e këtij niveli shumë të ulët të komunikimit dhe rrjeteve shoqërore ishin kufijtë e vendosur nga vendasit. Të intervistuarit deklaruan se ishin ndjerë si të ndryshëm: *"... Unë jam ndjerë i diskriminuar. Nëse do të shkoja në një dyqan dhe punonjësi i sigurisë do të më identifikonte, do të më ndiqte pas sikur të isha një hajdut. Pastaj, unë shkova në Shtutgart. Aty punonjësit e sigurisë ishin nga Kosova, kështu që ishte më e lehtë për ne sepse ata do të na ndihmonin me përkthimin, ose të merrnim letrën me anë të së cilës mund të tërhiqnim rroba nga Kryqi i Kuq."* (Intervistë 3-3).

Megjithatë, ka pasur raste kur disa shqiptarë i kanë zgjeruar rrjetet e tyre shoqërore përtej kurseve të gjuhës. Kjo ka ndodhur vetëm jashtë kampeve. Pasi vetëm jashtë, ata patën mundësi për të komunikuar me vendasit, dhe ata ishin shumë të kënaqur me ndihmën që mund të merrnin prej tyre. Migrantët shqiptarë pretendojnë se sa më shumë të ndërvepronin me gjermanët, aq më shumë respekt do të kishte secili në drejtim të tjetrit.

Një nga të intervistuarit[18] arriti të kontaktojë me profesionistë të ngjashëm në qytetin ku ai jetonte dhe gjithashtu të konkurronte zyrtarisht në nivele të ndryshme. Ai ishte shumë aktiv gjatë qëndrimit në Gjermani, dhe ushtroi aftësitë e tij sportive duke arritur që ta përballonte jetesën me shpenzimet e veta. Ai mundi të fitojë aftësitë bazë të gjuhës gjermane, që e lejuan të komunikonte mjaftueshëm dhe të ushtronte aktivitetet e mësipërme, por ai duhej të kthehej në Shqipëri, për shkak të mungesës së mundësisë për t'u pajisur me leje qëndrimi dhe pune.

[18] Mundësi profesionist

Ekzistonte gjithashtu probabiliteti për të marrë një urdhër dëbimi nga autoritet gjermane.

Pengesat gjuhësore dhe pamundësia për të qenë aktivë jashtë kampit, kufizuan rrjetin e migrantëve shqiptarë. Distanca kulturore me vendin pritës nuk i ka lehtësuar kontaktet fillestare. Megjithatë, duhet theksuar se pas thyerjes së distancës së parë, respekti reciprok ishte vendosur. Kur emigrantët shqiptarë filluan të komunikonin me shtetasit gjermanë, atëherë ata u takuan në përgjithësi me individë ndihmues dhe të dobishëm.

IV.5. Aksesi në shërbimet sociale

Nëpërmjet strehimit të lirë, kuponave apo ndihmës ushqimore, përdorimit falas të shërbimeve publike dhe veshmbathjes, të gjithë azilkërkuesit janë mbështetur nga qeveria gjermane duke përdorur falas shërbimin shëndetësor gjerman, përfshirë atë stomatologjik, psikologjik dhe social. Gjithashtu, ata u pajisën me të drejtën për t'u informuar dhe për të marrë ndihmë ligjore falas. Ata që kishin nevojë për trajtime të veçanta, si shtatzënitë ose sëmundjet e përhershme akute, kanë marrë ndihmën e duhur dhe shërbime pa pagesë.

Të gjithë të intervistuarit ishin të vetëdijshëm për këto përfitime dhe të gjithë lavdëruan cilësinë e tyre.

KUTIA 1:

.... Ndërsa gruaja ime dhe unë po përgatisnim disa dokumente, ne takuam rastësisht një zonjë gjermane. Ne u bënë miq dhe ajo vendosi të na ndihmonte. Ajo krijoi një dosje me dokumenta në mënyrë që unë të mund të gjeja një punë. Ajo më gjeti një vend pune si elektricist në një kompani ndërkombëtare, e cila operonte në nivel lokal. Ajo po përpiqej të gjente një hapësirë ligjore që mund t'i lejonte një azilkërkuesi pajisjen me një kontratë pune.
Në atë kohë (tetor 2015) u aprovua ligji i ri që i ndalonte azilkërkuesit të kishin një kontratë pune, leje punësimi ose viza. Zonja arriti të më siguronte një bursë (rreth 250 € /muaj) nga Deutsche Post dhe unë u punësova nga kompania elektrike për 1 javë punë dhe 1 javë studim, me kusht që të hiqja dorë nga statusi i asistencës sociale. Ajo kishte arritur të merrte me qera edhe një shtëpi moderne me një çmim të ulët për ne.
Kompania më premtoi një pagë prej 1,000 € /muaj për gjashtëmujorin e parë dhe pastaj një rritje pozicioni si asistent elektricist, fillimisht me një rrogë 2,500 € /muaj dhe më pas mund të arrinte shumën 4,000 € /muaj me një kontratë të përhershme. Në fillim autoritetet bashkiake vendase duket se e pranuan një marrëveshje të tillë, por më vonë ata deklaruan se kjo procedurë nuk mund të aplikohet për shqiptarët. Sikur të kishim pasur një nënshtetësi tjetër, do të kisha qenë në gjendje ta fitoja këtë pozicion pune. Megjithatë, ndihem borxhli ndaj zonjës që më ndihmoi". (Intervista 4-2).

Ndonjëherë ata përmendën faktin se kishin pritur një kohë të gjatë për të marrë shërbimet shëndetësore, por ishin të vetëdijshëm për përpjekjet e punonjësve të shëndetësisë dhe ngarkesën e punës. Rastet më pak të rënda shëndetësore u vunë në lista pritjesh për shkak të numrit të madh të njerëzve nëpër kampe dhe numrit të vogël të infermierëve.

Një përfitim i pakonsideruar i qëndrimit të tyre në Gjermani ishte këndvështrimi krahasues mbi shërbimet publike. Gjatë intervistave ata shpesh krahasonin sektorin publik shqiptar me atë gjerman.

IV.6. Njohja me gjermanët

Përshtypja e përgjithshme mbi marrëdhëniet me punonjësit publikë, mësuesit e gjuhës, punonjësit dhe asistentët socialë, si dhe ndërveprimi i përditshëm me popullin gjerman, ishte pozitive. Shumica e të intervistuarve pohojnë se zyrtarët vendas dhe njerëzit ishin të sjellshëm, të dobishëm, mbështetës dhe miqësorë; ata ndiheshin të respektuar prej tyre dhe e vlerësonin

ndihmën dhe asistencën e marrë. Sa më shumë kontakt që kishin, aq më tepër ishin të kënaqur nga ndërveprimi me zyrtarët gjermanë. Anasjelltas, sa më shumë të qëndronin në mjedisin e tyre shqiptar, aq më të pakënaqur ndiheshin.

Disa nga të intervistuarit u ankuan për kushtet dhe mënyrën se si janë trajtuar nëpër kampe. Gjithashtu, të tjerë kanë pohuar se edhe pse në përgjithësi përvoja e tyre ka qenë pozitive, ka pasur punonjës që i shikonin me dyshim ata dhe familjet e tyre. Ka pasur disa raportime për sjellje të keqe të punonjësve publikë të kombësive të tjera. Kur u pyetën për të treguar më tej, ata nuk dhanë detaje. Në kuptimin tonë, sjellja e këtyre punonjësve nëpër kampe mund të shpjegohet me zbatimin e rreptë të rregullave procedurale.

Duhet të theksojmë se ndihet një mungesë e caktuar komunikimi me autoritetet, përsa i përket çështjeve shumë të rëndësishme, si p.sh. statusi i rezidencës në Gjermani. Pas kaq shumë muajve, migrantët shqiptarë akoma nuk i kishin të qarta procedurat që do t'i lejonin ata të jetonin dhe punonin atje në mënyrë të ligjshme, ose i zbuluan këto procedura në momentin e fundit para se të merrnin urdhërin për t'u larguar nga vendi.

Disa prej të intervistuarve që u kthyen pas vendimit negativ të kërkesës për azil, pretendojnë se ata duhej të largoheshin pasi nuk patën mundësi të gjenin një punë ndërkohë. Të tjerë pohuan se e kishin gjetur një punë dhe ishin gati për të filluar, kur u mor vendimi negativ për aplikimin e tyre për azil. Gjashtë prej tyre janë të sigurt se iu dha urdhër dëbimi nga 6 deri në 30 muaj; shumicës prej tyre i është dhënë 2 vjet dëbim. Disa nuk e kanë të qartë nëse kanë marrë ndonjë urdhër dëbimi[19].

IV.7. Çfarë pëlqyen në Gjermani

Standardet e larta të jetesës, planifikimi i së ardhmes dhe sundimi i ligjit - të gjithë faktorë fillestarë shtytës, që u bënë shkak për largimin e tyre - janë renditur si gjërat kryesore që migrantët pëlqenin në Gjermani. Të gjithë mendonin se në Gjermani do të fitonin një perspektivë shumë më të mirë për të ardhmen e tyre, diçka që u mungonte në Shqipëri. Në përgjithësi, ata gjithashtu vlerësonin sjelljen e punonjësve publikë, disiplinën, rregullat e qarta, strikte dhe procedurat, sigurinë fizike dhe paqen sociale, mbrojtjen sociale, nivelin e ulët, gati inekzistent, të diskriminimit racial apo etnik, qytetet, mjedisin e pastër dhe të qetë, cilësinë e shërbimeve publike, kulturën e punës - thjesht të vëzhguara ose nga eksperienca, mënyra si gjermanët i përshëndesnin ata në rrugë dhe si komunikonin me ta, solidariteti i disa vendasve dhe gatishmëria për t'i ndihmuar.

Ka pasur disa gjëra që ata nuk i parapëlqenin kryesisht nga periudha e kaluar nëpër kampe. Një nga faktet me të rëndësishëm për t'u përmendur ishte se ata e kalonin pa aktivitete gjithë ditën, të izoluar dhe nuk iu lejohej të punonin. Ndiheshin të frustruar nga vështirësitë që kishin hasur për të marrë një vizë pune ose në rastet kur kishin mundur të gjenin një punë, kur aftësitë e tyre / profesioni ishin sipas kërkesës së tregut vendas të punës. Në këtë perceptim nuk kishte asnjë kuptim përse të mos punësoheshin kur ekzistonte një punëdhënës i gatshëm për t'u ofruar atyre një punë. Ndjekja e hapave administrative dhe procedurale dukej pothuajse e pamundur për ta. Nga kjo ju krijohej perceptimi i pabesueshëm se për t'u pajisur me leje pune në Gjermani ishte shumë e vështirë. Faktikisht, aplikimi për azil dhe mbrojtje, u bë shkak që punësimi i tyre në Gjermani të ishte i pamundur. Më tej përmendet dhe mosbesimi në ndonjë rast nga ana e vendasve ose e disa punonjësve publikë.

Koha që kaluan në Gjermani i shërbeu migrantëve shqiptarë të krijonin një perspektivë të ndryshme sesi duhet të funksionojnë shërbimet shtetërore dhe shteti. Një sistem i efikas dhe i drejtë është ai që ata duket se kanë pëlqyer dhe e vlerësojnë më së shumti. Por, kur përballen me detyrimin për të ndjekur rregullat dhe t'i përshtaten atyre, ata shfaqin shenja mosrespektimi

[19] Gjysma e të intervistuarve nuk kanë marrë urdhër dëbimi për zonën Schengen

dhe rezistence. Megjithatë, për individët që kishin mundësinë për t'u ingranuar në kontekstin gjerman, kjo rezistencë u zhduk. Tani ata të gjithë lavdërojnë efikasitetin gjerman, por ankohen për numrin dhe kompleksitetin e procedurave që duheshin ndjekur për t'u bërë pjesë e sistemit.

IV.8. Mësimet e nxjerra

Të gjithë të intervistuarit ishin dakord se zgjedhja e azilit ishte e gabuar dhe se ata duhet të ishin informuar më mirë para se të largoheshin nga Shqipëria. Tashmë për ata është e qartë se ishte shumë i vështirë qëndrimi në mënyrë të paligjshme në Gjermani. *"... Mendova se duke m'u ofruar një punë, qëndrimi në Gjermani nuk do të ishte problem. Por pasi me urdhëruan të largohesha, e kuptova se kërkimi i azilit ishte zgjedhja më e keqe që unë mund të kisha bërë"*. (Intervista 6-1). Ata janë të vetëdijshëm se përveç respektimit te ligjeve dhe procedurave të migrimit, duhet të fitojnë aftësi për punë dhe të jenë të përgatitur në profesionet e tyre, para se të marrin në konsideratë mundësitë për migrim. Përveç lejes së punës, vizës së punës ose lejes së qëndrimit, ata gjithashtu rendisin njohuritë e gjuhës gjermane si një pengesë kyçe për të kërkuar një vizë pune / punë.

Në mesin e të intervistuarve, të cilët ishin të punësuar dhe / ose ekonomikisht më mirë, shprehet keqardhje për mënyrën se si ata u larguan për në Gjermani. Megjithatë, ata mendojnë se kjo përvojë i ka ndihmuar që të vlerësojnë atë çfarë kanë në Shqipëri. Ata u larguan për kushte më të mira pune, për të bërë disa para që të blinin një shtëpi / pronë dhe më pas do të ktheheshin, nuk kishin ndërmend të qëndronin atje përgjithmonë. *"Kjo nuk ishte rruga e duhur. Kjo përvojë nuk ishte për mua, pasi Shqipëria është më e mirë se ajo që kam përjetuar. Nuk shkova atje për të qëndruar. Unë nuk isha dikush që kishte nevojë për ndihmë sociale. Unë shkova atje për të gjetur kushte më të mira pune. Në përgjithësi, përvoja ishte e mirë, por kurrë nuk do të shkoja si azilkërkues."* (Intervista 4-3).

Grupi i të kthyerve është një burim i paçmueshëm dhe vektor i informacionit që demaskon mitin e Eldorados në Gjermani. Së pari, si një burim parësor informacioni ata kanë besueshmërinë e eksperiencës atje. Së dyti, ata janë një vektor efikas i informacionit për shkak të karakteristikave të mbledhjes së informacionit gojë-më-gojë mes shqiptarëve. Këta njerëz mund të "përdoren" për të zbuluar se cilët do të jenë migrantët e ardhshëm që mund të largohen dhe që ndodhen jashtë radarit të kanaleve zyrtare d.m.th. DIMAK, Sporteleve të Migrimit apo kompanive private.

Një element që ia vlen të theksohet, ishte shtrembërimi i informacionit nga sisteme të ndryshme të emigrimit në shtetet anëtare të BE-së. Vala e parë e migrantëve shqiptarë u vendos kryesisht në Greqi dhe Itali. Në të dyja këto vende ishte e mundur të jetoje, punoje, përfitoje nga shërbimet publike, regjistroje fëmijët në shkollë, etj., duke aplikuar si azilkërkues. Procedura mund të zgjaste vite dhe migrantët shqiptarë do të kishin një jetë "normale", edhe në qoftë se nuk formalizoheshin ligjërisht. Për më tepër, dhe kjo është e rëndësishme, ata mund "të sistemonin" situatën e tyre edhe pasi kërkesa për azil të ishte ndoshta refuzuar. Kjo është përvoja që shumë nga shqiptarët që migruan në Greqi dhe Itali e quanin si të mirëfilltë dhe u përdor si një pikë referimi kur migroi vala e dytë në Gjermani. Me përjashtim të faktit se sistemi gjerman ka dy dallime karakteristike: (i) kërkesa për azil merr shumë më pak kohë për t'u përpunuar, dhe (ii) nuk ka asnjë shans për të mos u deportuar pasi kërkesa të jetë refuzuar. Shqiptarët e mësuan këtë përmes mënyrës më të vështirë.

V. KTHIMI NË SHQIPËRI

Për kthimin në Shqipëri u ndoq i njëjti model si nisja: ishte nje vendim i shpejtë, por këtë herë i manaxhuar nga autoritetet gjermane. Në Shqipëri migrantët gjetën të njëjtin realitet si më parë dhe kjo është arsyeja pse ata duan të rikthehen ... në Gjermani.

V.1. Shumica u kthyen vetë pas refuzimit të kërkesës për azil

Migrantët / azilkërkuesit e refuzuar që kemi intervistuar kanë qëndruar në Shqipëri nga 4 deri në 12 muaj para intervistës. Shumica e tyre ishin kthyer prej më shumë se 9 muajsh, d.m.th ata janë kthyer nga Gjermania përpara janarit 2016. Një pjesë e madhe e personave që intervistuam ishin kthyer kryesisht vetëm pas marrjes së rezultatit negativ të kërkesës së tyre për azil. Komunikimi i qartë nga ana e autoriteteve gjermane për pasojat e mosrespektimit të këtij vendimi, i ndihmoi ata të vendosnin.

Për disa prej tyre, autoritetet gjermane e kishin organizuar kthimin. Ata duhet të ktheheshin përsëri në kamp dhe pastaj të deportoheshin në Shqipëri. Të tjerë u kthyen me mjetet e tyre, menjëherë pas marrjes së vendimit negativ. Arsyeja pse ata nuk pritën të deportoheshin[20] ishte pasi atyre iu tha se policia gjermane do t'i detyronte të largoheshin në çdo orë - ditën apo natën - në rast se ata nuk niseshin në datën e caktuar.

Ata që u kthyen, si rezultat i një vendimi negativ i kërkesës së tyre për azil, ishin më të vendosur për të qëndruar. Ata kurrë nuk do të ishin kthyer sikur të kishin pasur një zgjedhje. Megjithatë, ata pak që u dëbuan, ndjenin keqardhje që nuk respektuan lejen tre-mujore të qëndrimit, pasi kjo penalizon çdo kërkesë të ardhshme për t'u kthyer ligjërisht në Gjermani. Megjithatë, ata janë të gatshëm për të eksploruar mundësi që të kthehen ligjërisht në Gjermani për të punuar. Të gjithë të intervistuarit shprehën synimin e tyre për të migruar sërish.

Një grup i dytë, natyrisht në kushte më të mira ekonomike, vendosi të kthehet para se ndonjë vendim tjetër të merrej mbi aplikimin e mëtejshëm për azil. Ata pohuan se u kthyen pasi nuk mund t'i duronin më kushtet dhe jetën nëpër kampe. Kur krahasonin kushtet e jetesës nëpër kampe me ato në Shqipëri, ata vendosën se nuk ia vlente. Ata mund të klasifikohen si persona qe kanë pasur një punë të kënaqshme dhe gjendje të mirë financiare. Ata nuk kishin ndërmend të jetonin me ndihma sociale dhe aspironin për të punuar atje. Kur e kuptuan se kjo ishte e pamundur, vendosën të kthehen në Shqipëri. Këta individë u paguan për kthimin dhe e organizuan vetë atë. Ky grup është një ndër ata që ka kaluar më pak kohë në Gjermani, në krahasim me intervistuesit e tjerë.

V.2. Re-integrimi në sistem në Shqipëri

Çereku i pjesëmarrësve nuk kanë pasur asnjë kontakt me ndonjë institucion publik [21] në Shqipëri që prej kthimit të tyre. Ata sillen sikur nuk janë larguar kurrë nga Shqipëria apo nuk kanë kërkuar azil në një vend të BE-së. Megjithatë, ata kanë qenë të paktën një herë në Ambasadën Gjermane në Tiranë pas kthimit në Shqipëri. Ata pretendojnë se e vizituan ambasadën për të dorëzuar dokumentet ose të merrnin informacion në lidhje me ndonjë kufizim të lëvizshmërisë që mund të kanë pasur pas refuzimit të kërkesës për azil dhe urdhërit për largim.

[20] …. dhe kursyen shpenzimet e biletës së kthimit
[21] Përveç sistemit shkollor

Dy nga pjesëmarrësit pohuan se kanë qenë në Zyrën e Punësimit (ZP) në qytetin ku ata jetojnë. Njëri prej tyre ishte regjistruar në janar 2016 dhe asnjëherë nuk ka dëgjuar nga Zyra e Punës që nga ajo kohë, ndërsa një tjetër nuk ishte regjistruar nga autoritetet e ZP-së. Atij i kishin thënë se ishte e pamundur të gjendej një punë për të, sepse nuk kishte arsim dhe nuk kishte asnjë profesion. Asnjë kontakt i mëtejshëm nuk iu ofrua ndonjërit prej tyre. Ata që kishin ndjekur studimet, u kthyen në shkolla / universite, meqenëse asnjë penalitet nuk kishte hyrë në fuqi për personat që i ndërpresin studimet për të migruar.

Migrimi i fëmijëve, dhe ri-integrimi i tyre në sistemin shkollor pas kthimit është një problem i vërtetë. Sipas drejtorit të Shkollës së Mesme "Jordan Misja" në Shkodër, në semestrin e parë të vitit 2014, më shumë se 10% e nxënësve u larguan me familjet e tyre. Prej atëhere, gjysma e tyre janë kthyer. Një tendencë e përsëritur është vërejtur edhe gjatë periudhës shtator - tetor 2016. Në gjashtë raste prindërit kanë kërkuar leje për mungesat e gjata të fëmijëve të tyre. Qëllimi ishte për të migruar, por duke pasur parasysh se ata janë të pasigurt në lidhje me mundësinë për të qëndruar, thjesht duan të mbajnë opsionet e tyre të hapura. Në shumë raste, pas kthimit, prindërit kërkojnë njohjen e viteve të shkollimit / krediteve që fëmijët kanë marrë jashtë vendit[22].

Shkëputja dhe moskomunikimi me institucionet dhe / ose administratën zyrtare është një tipar i vazhdueshëm i grupit tonë të migrantëve. Pavarësisht nëse ata janë në Gjermani ose në Shqipëri, e kanë të vështirë që të lidhen me administratën dhe të komunikojnë me të. Kjo sjellje e bën jashtëzakonisht të vështirë përfshirjen e tyre në sistem - qoftë në Gjermani apo në Shqipëri - pavarësisht cilësisë së shërbimeve të kësaj të fundit.

Për këtë arsye, administrata duhet të vlerësojë me kujdes angazhimin me këtë grup. Një qasje më energjike, përdorimi i strukturave komunitare dhe faktorë të tjerë specifikë kulturorë, përfundimisht mund të ndihmojnë për të përhapur informacionin dhe për të vendosur një dinamikë bashkëpunimi të individit me administratën.

V.3. Dëshira për migrim ngelet po aq e fortë si më parë…

Që prej kthimit të tyre, disa prej të intervistuarve kanë gjetur një punë, të tjerë iu kthyen profesioneve të mëparshme. Megjithatë, ata ende raportojnë se janë duke hasur të njëjtat probleme me punësimin, siç i kanë patur para se të niseshin, pagat e ulëta, pasiguria në punë, punët sezonale, orët e gjata të punës dhe papunësia. Disa të rinj janë kthyer nëpër shkolla: ata që ndjekin studimet universitare punojnë ndonjëherë me kohë të pjesshme. Të tjerët janë të papunë ose në kërkim të një pune.

KUTIA 2

"…Po, po planifikoj të iki sërish në Gjermani, sepse kjo ka qenë ëndrra ime që kur isha fëmijë. Arsyeja përse dëshiroj të largohem është gjithmonë e njëjta: kushtet e vështira ekonomike. Unë kam një punë me kohë të pjesshme dhe fitoj 120 euro në muaj. Nuk e kam planifikuar ende udhëtimin në detaje, por mendoj se mund të largohem rreth muajit mars/ prill 2017, pasi në këtë periudhë do të kem përfunduar kurset e mia.

Po planifikoj të iki në Gjermani për të punuar në profesionin tim. Në rast se mund të gjejë kurse arsimimi përsa kohë jam atje, mbetem i hapur ndaj kësaj alternative. Megjithatë, arsyeja kryesore përse dua të iki në Gjermani mbetet puna. Nuk kam ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me udhëtimin, por besoj se ka kohë për këtë gjë". (Intervista 2-1).

[22] Ndërsa Ministria e Arsimit dhe Sportit ka udhëzuar institucionet arsimore të lehtësojnë ri-integrimin e fëmijëve të kthyer nga jashtë në sistemin arsimor shqiptar, sidoqoftë ka raste si p.sh. e fëmijëve të lindur jashtë, kur bëhet shumë e vështirë veçanërisht për lëndët në gjuhën shqipe.

Pavarësisht nga kushtet e punës, statusit të papunësisë dhe kushteve të jetesës në Shqipëri, disa prej tyre po ndjekin kurse të gjuhës gjermane dhe / ose kurse profesionale që do t'iu mundësonin jo vetëm zhvillimin e aftësive të tregut të punës, por edhe marrjen e certifikatave dhe do të lehtësonin kthimin e tyre të ligjshëm në Gjermani për qëllime punësimi.

Në thelb, pas kthimit ata kanë vazhduar rutinën e tyre njëlloj si përpara largimit, shkojnë në punë, studiojnë apo vazhdojnë të jenë të papunë. Sidoqoftë, përvoja gjermane u ka shërbyer si një thirrje për zgjim - tani ata e dinë se nëse e mesojnë mjaft mirë gjuhën dhe / ose të jenë të aftë në profesionet e zgjedhura, Gjermania u jep atyre një shans. Mësimi i gjuhës dhe/ose regjistrimi në AFP janë jashtëzakonisht të dobishëm për të përfshirë këtë grup në aktivitete produktive dhe fitimprurëse, gati po aq të rëndësishme sa ofrimi i një objektivi në jetë.

V.4. … Por .. nëpërmjet procedurave të duhura

Vetëm një nga pjesëmarrësit nëpër intervistat tona pohoi se nuk ka dëshirë për t'u kthyer në BE. Të tjerët kanë deklaruar se do të dëshironin të largoheshin nga Shqipëria[23] sapo të përfundojë periudha e tyre e dëbimit nga zona Schengen. Shumica e tyre do të dëshironte të kthehej në Gjermani. Ata kanë në plan të shkojnë me një kontratë pune dhe të jenë të shoqëruar nga anëtarët e familjeve të tyre.

Faktorët shtytës dhe arsyet për të ri-emigruar janë po ato që i çuan drejt vendimit të parë të migrimit, jo shumë kohë më parë. Ata dëshirojnë një jetë më të mirë për vete dhe për fëmijët e tyre, mundësinë për të fituar të ardhura të mjaftueshme për të kapërcyer vështirësitë financiare që ndeshin në Shqipëri, mundësi punësimi dhe kushte më të mira pune. Një nga të intervistuarit pohoi: *"Asgjë nuk funksionon këtu[24]. Jeta nuk është e sigurt. Ka korrupsion. Paga nuk është e mjaftueshme për një person të vetëm, e jo me kur ke një familje ..."* (Intervista 3-3). Përveç kësaj, ata ndihen pesimistë për të ardhmen e tyre dhe të vendit, duke përmendur nivelet e larta të korrupsionit, nepotizmit dhe diskriminimit. Problemet sociale dhe siguria e jetës janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm shtytës.

Përsa i përket faktorëve tërheqës, disa nga pjesëmarrësit janë duke përdorur rrjetet dhe miqtë që kanë në Gjermani për të kërkuar mundësi punësimi. Ata që arritën të marrin një ofertë për punësim përpara kthimit, po e përdorin atë për t'u angazhuar në procedurën e migrimit të ligjshëm. Të tjerë po planifikojnë momentin e duhur, ndërkohë që presin përfundimin e periudhës së dëbimit ose të kompletojnë kurset e gjuhës / AFP-së. Shumë prej tyre janë duke kursyer para për të paguar udhëtimin. Një nga kryefamiljarët e intervistuar pohoi gjithashtu se të dy djemtë e tij ishin tashmë në Itali dhe po përpiqeshin të gjenin punë për të financuar migrimin e ardhshëm të familjes në Gjermani.

Në pikëpamjen tonë, faktorët shtytës mbeten të njëjtë. Faktorët tërheqës janë gjithashtu të njëjtit, por shumë më të qartë, më mirë të përcaktuar dhe mbi të gjitha, të kuptueshëm. Të kthyerit, të predispozuar për të emigruar sërish, kanë më shumë njohuri për vendin ku duan të shkojnë dhe kjo ndikon drejtpërdrejtë në mënyrën se si ata dhe familjet e tyre po përgatiten për udhëtimin e ardhshëm. Kjo situatë informimi do të ishte një objektiv ideal për të gjithë ata që planifikojnë të emigrojnë.

V.5. Ende ka probleme me informacionin, ... por shumë më pak se më parë

Pothuajse gjysma e të intervistuarve nuk kishte asnjë informacion të përditësuar mbi migrimin e ligjshëm në Gjermani pasi u kthyen; ata dinin vetëm çka u nda me ta gjatë qëndrimit të tyre në Gjermani. Ky informacion është mjaft i çrregullt dhe i pasaktë. Ata e dinë këtë fakt, por do të

[23] Gjermania, Anglia,Islanda, SHBA, Franca, Suedia janë ndër destinationet e preferuara.

[24] ..... në Shqipëri

kërkojnë për informacion të përshtatshëm pasi të kanë sistemuar çdogjë dhe të jenë gati për t'u larguar. Grupi tjetër i pjesëmarrësve, që pretendojnë se zotërojnë një informacion të përditësuar mbi migrimin e ligjshëm, gjithashtu ka një informacion të limituar dhe të fragmentuar. Ata që po planifikojnë të kthehen së shpejti, deklaruan se disponojnë më shumë informacion se të tjerët në lidhje me mundësitë e migrimit dhe procedurat për t'u ndjekur.

Shumica e tyre e dinë, se për të shkuar në Gjermani për punësim, kanë nevojë të aplikojnë dhe të kenë në dispozicion një kontratë pune përpara nisjes, dhe se procedura duhet të përfundojë në Ambasadën Gjermane në Tiranë. Disa prej tyre kanë përmendur bashkimin familjar, studimet ose të martohen me shtetas/e gjermane/ë, por këto konsiderohen si mënyra të vështira. Një nga pjesëmarrësit ka përmendur alternativën për të aplikuar nëpërmjet disa organizatave, të cilat ndihmojnë në gjetjen e kontratave për punë afat-shkurtra. Këto janë kompanitë e shërbimeve private, ku duhet paguar në këmbim të plotësimit të formularëve të aplikimit dhe premtimit për të gjetur një punë.

Në përgjithësi informacioni mbi ri-emigrimin ishte mjaft i pakët dhe i papërshtatshëm. Rregulli, sipas së cilit nuk është e mjaftueshme të kesh një ofertë pune, por duhet të sigurohemi që asnjë shtetas tjetër gjerman nuk ka interes për ta zënë atë pozicion, nuk ishte i qartë për ata që aplikonin përpara se të migronin. Nevoja për informacion të qartë, i transmetuar në mënyra të kuptueshme, është shumë i rëndësishëm për këtë target grup, pasi vetëm kështu sigurohet një qasje ligjore dhe shmangen agjentët e tregut të zi.

V.6. Migrimi i paligjshëm vazhdon të ekzistojë

Ekziston një tendencë e përgjithshme në mesin e të intervistuarve përsa i përket faktit se ata nuk duan të migrojnë në mënyrë të paligjshme drejt Gjermanisë, ose të aplikojnë për azil, edhe pse ata dëshirojnë të largohen nga vendi. Ata pohuan se do të dëshironin të shkonin atje në mënyrë të ligjshme. Megjithatë, ka pasur disa pjesëmarrës të cilët ndanë me ne idenë, se ata do të përpiqen të largohen në mënyrë të paligjshme, në qoftë se nuk ia dalin dot përmes vizave të punës, dhe veçanërisht nëse punësimi dhe gjendja ekonomike në Shqipëri do të përkeqësohen.

Kishte një trend interesant në përgjigje: Individët të cilët e konsiderojnë mundësinë e migrimit të paligjshëm janë në kontakt me migrantë të interesuar në përdorimin e rrjeteve të paligjshme të migrimit. *"Po, unë do të përdorja migrimin e paligjshëm në qoftë se do të kisha mundësi. Nëse unë do të gjeja një punë "nën tavolinë", do të shkoja që tani në Gjermani. Shumica e miqve të mi duan të shkojnë në Gjermani në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme. Ndoshta njoh rreth 50 njerëz që mund të përdornin migrimin e paligjshëm ..."* (Intervista 2-2).

Ana pozitive është fakti se migrimi i ligjshëm është opsioni i parë për ata që dëshirojnë të kthehen në Gjermani. Sfida e tyre është zbatimi i këtij plani dhe për ta realizuar atë, duhet të jenë më mirë të përgatitur për tregun gjerman të punës, si dhe të njohin shumë më mirë procedurat e migrimit. Migrimi i paligjshëm mbetet si mundësi e dytë më e mirë, sidomos për ata që janë në kontakt me raste të ngjashme dhe rrjete[25] që promovojnë migrimin e paligjshëm.

V.7. A i njohin ata kushtet dhe procedurën për migrimin e ligjshëm?

Ekzistojnë vetëm tre mënyra për të marrë qëndrim të ligjshëm në Gjermani: (i) përmes Kartës Blue: me kusht që aplikanti të ketë një kontratë pune, kualifikimet e kërkuara dhe njohuri të gjuhës gjermane; (ii) duke studiuar: me kusht që aplikanti të disponojë një diplomë të shkollës

[25] 34.000 kërkesa për azil nga Shqiperia u paraqitën në periudhën Janar - Tetor 2016. Vetëm 10 prej tyre u pranuan, më së shumti, sepse aplikanti ishte i martuar me një refugjat azilant ekzistues. 69 persona morën mbrojtje suplementare, pasi kushtet në qendrat shqiptare të ndalimit nuk i përmbushin standardet e BE-së (vetëm burgu i Fierit është i certifikuar si i tillë), dhe 65 persona morën mbrojtje kombëtare për shkak të gjakmarrjes. Burimi: Ambasada Gjermane në Shqipëri, Tiranë.

së mesme dhe njohuri të gjuhës gjermane, dhe (iii) që nga janari 2016, tregu gjerman i punës është i hapur për punëtorët e pakualifikuar me kusht që ata të kenë një kontratë pune, për një leje fillestare qendrimi deri në dy vjet, dhe të jetë e rinovueshme.

Në lidhje me parakushtet dhe procedurat mbi migrimin e ligjshëm, gjetjet tona tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve i njohin kushtet e përgjithshme të migrimit në Gjermani apo çdo vendi tjetër europian, por ata nuk i njohin kriteret paraprake dhe procedurat specifike rreth migrimit të ligjshëm. Disa prej tyre e njohin faqen internet "Make it to Germany" dhe gjithashtu mund të përmendin disa nga profesionet që kërkohen në tregun gjerman të punës. Disa të tjerë ndajnë njohuri të gjera për mënyrat e migrimit të ligjshëm të njerëzve të tjerë në Gjermani. Një pjesë e vogël e pjesëmarrësve nuk janë të vetëdijshëm në lidhje me te gjitha procedurat e migrimit, përveçse nevojën e tregut gjerman për fuqi punëtore.

Sigurimi i informacionit mbi tregun gjerman të punës dhe mënyra për të depërtuar në të është jashtëzakonisht i nevojshëm përsa i përket procedurave efikase të migrimit të ligjshëm. Për më tepër, i lejon kandidatët të përgatiten siç duhet dhe redukton përpjekjet e mafias dhe rrjeteve te tjera të migrimit të paligjshëm të përfitojnë nga dëshpërimi dhe injoranca e migrantëve të ardhshëm. Është e një rëndësie jetike për autoritetet - në Shqipëri dhe Gjermani - të kuptojnë se ekziston një pjesë e madhe individësh të predispozuar për migrim të cilët nuk shfaqen në radarët e tyre. Këta individë përdorin rrjetet informale për të marrë informacion, nuk kanë aspak / fare pak akses në internet, karakterizohen nga një nivel i ulët arsimor dhe nuk janë mësuar të bashkëveprojnë me administratën. Më tej, pjesa më e madhe e tyre banon në zona rurale dhe nuk mund të përballojë udhëtimin në qytetet kryesore për të marrë informacionin e vlefshëm. Ky grup nuk i përshtatet profilit që kërkon Gjermania. Por kjo nuk do të thotë se ata nuk do të përpiqen për të shkuar atje. Ata janë preja më e lehtë e fushatës së mos-informimit apo e trafikantëve të qenieve njerëzore, dhe nuk kanë asgjë për të humbur. Mënyra të reja dhe inovative duhet të zbatohen për të informuar këta individë mbi të drejtat dhe mundësitë e tyre.

VI. KONTEKSTI INSTITUCIONAL DHE LIGJOR PËR RI-INTEGRIMIN

Migrimi është një tipar karakterizues i shqiptarëve gjatë gjithë historisë së tyre. Artificialisht ka ndaluar vetëm gjatë periudhës së regjimit komunist ndërmjet 1944 - 1991, por është shfaqur duke përcaktuar demografinë e vendit dhe shumë shpesh ka ndikuar në marrëdhëniet me vendet fqinje. Në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE, lëvizja e lirë pa viza dhe më tej lëvizja e lirë e njerëzve mund ta shndërrojë migrimin në një pikë referimi kushtëzues për ritmin e progresit drejt rrugës së anëtarësimit. Ky fakt bëhet edhe më i rëndësishëm në zhvillimet aktuale gjeo - politike që prekin edhe Bashkimin Europian.

VI.1. Një e treta e popullsisë shqiptare është larguar nga vendi që nga viti 1991

Në dekadën e fundit të shekullit XX, 1991-2000, një rritje masive e emigracionit shqiptar është shënuar në lidhje me dy faktorë kryesorë: rënia e regjimit komunist dhe emigracioni masiv drejt Italisë dhe Greqisë, si dhe kriza e marsit 1997 për shkak të falimentimit të skemave financiare piramidale. Sipas të dhënave të fundit rreth 1,5-2 milionë shqiptarë ndodhen[26] jashtë vendit, kryesisht në: (i) 0,5-0,6 milionë në Greqi; (ii) 0,5-0,6 milionë në Itali, dhe; (iii) 0,1 milion në SHBA, etj.

Bazuar në profilin e zgjeruar të migrimit shqiptar 2012 - 2014 - një publikim i Ministrisë së Punëve të Brendshme i dhjetorit 2015 – informohemi se ka pasur 1,4 - 1,5 milion emigrantë në vitin 2011, ose 33% e gjithë popullsisë së vendit (INSTAT, 2011).

VI.2. Fenomeni i kthimit

Tipologjia e emigrantëve shqiptarë të kthyer gjatë 2012-2016 përbëhet nga katër grupe: (i) kthimi vullnetar i emigrantëve ekonomikë; (ii) kthimi i emigrantëve ekonomikë për shkak të krizës në vendet pritëse, Itali, Greqi; (iii) kthimin i miturve, dhe, (iv) kthimi i detyruar.

Ky i fundit është pasojë e rritjes së kthimeve të emigrantëve të parregullt nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së (kryesisht në Gjermani, Belgjikë, Francë, etj) dhe pasqyron fenomenin e "azilkërkuesit". Kjo arritje vjen si rezultat i përmbushjes së detyrimeve të qeverisë shqiptare në kuadër të integrimit në BE. Për këtë arsye, më 14 prill 2005 u nënshkrua Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë e cila hyri në fuqi më 1 maj 2006 për shtetasit shqiptarë dhe më 1 maj 2008 për shtetasit nga vende të treta.

VI.3. Konteksti institucional

Në aspektin e kornizës institucionale në lidhje me kthimin dhe ri-integrimin e shtetasve shqiptarë, lista e institucioneve të përfshira dhe përgjegjëse është si më poshtë:

1. Ministria e Brendshme është aktori i parë që punon në procesin e rikthimit. Ajo drejton sistemin e të dhënave për hyrjet e shtetasve shqiptarë të kthyer në pikë kalimet kufitare nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit (Komisioni Europian, 2016) që është pjesë e Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë. Brenda kësaj drejtorie, Departamenti kryesor është Departamenti i Migracionit[27];
2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) është përgjegjëse për ri-integrimin e personave të kthyer në kuadër të politikave sociale dhe punësimit. Departamenti kryesor

[26] http://cid.harvard.edu/ciddata.html

[27] Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Brendshme janë të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 9668, datë 18.12.2016: "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi"

përgjegjës brenda MMSR është Drejtoria për Politikat e Punësimit dhe Migrimin[28];

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP). Në SHKP, drejtoria kryesore përgjegjëse për çështjet e migrimit është Drejtoria për Shërbimin e Punësimit dhe Migrimin. Në nivel rajonal dhe lokal, Shërbimi Kombëtar i Punësimit disponon vetëm një person përgjegjës të ngarkuar në Sportelin e Migracionit - një pikë kryesore në nivel lokal që: (i) mbledh informacion të detajuar mbi shtetasit shqiptarë të kthyer, (ii) vlerëson domosdoshmëritë e tyre, iu siguron informacion sipas nevojave përkatëse dhe i adreson ata në institucionet që ofrojnë shërbime fokale, të tilla si shëndeti, arsimi, punësimi dhe kështu me radhë;
4. Ministria e Punëve të Jashtme[29];
5. Ministria e Arsimit dhe Sporteve; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Financave janë të gjitashtu të përfshira në çështjet që bien në fushën e tyre të përgjegjësisë.

VI.4. Konteksti ligjor

Baza ligjore për kthimin dhe ripranimin është pjesë integrale e ligjit për migracionin në Republikën e Shqipërisë. Legjislacioni kombëtar për ripranim përbëhet nga:

- Marrëveshja e Ripranimit ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë që u nënshkrua më 14 prill 2015 dhe hyri në fuqi më 1 maj të vitit 2006 me qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit efektiv në luftën kundër emigrimit të paligjshëm dhe vendosjen e procedurave të qarta dhe metodave të identifikimit dhe kthimit të sigurt të njerëzve, të cilët nuk i plotësojnë kërkesat për hyrje ose qëndrim në Shqipëri, ose në shtetet anëtare të BE-së;
- Zbatimi i Protokolleve të Marrëveshjes së Ripranimit me shtetet si: Gjermania, Austria, Britania e Madhe, Belgjika, Luksemburgu, Hollanda, Danimarka, Italia, Republika Çeke, Sllovakia, Rumania, Hungaria dhe vendet jo anëtare të BE-së, si Zvicra, Norvegjia, Islanda mbi ripranimin, Ligji Nr.108/2013 "Për të huajt";
- Ligji Nr. 108/2014, datë 31/07/2014 , "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji Nr. 108/2013 "Për të huajt"[30], ndryshuar me ligjin Nr. 75/2016, datë 2016/07/14;
- Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi"; ndryshuar me ligjin Nr. 10389, datë 2011/03/03;
- Urdhër Nr. 83, datë 2011/06/06 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: "Për formën, përmbajtjen dhe procedurat për përfitimin e statusit të emigrantit";
- Urdhër Nr. 84, datë 2011/06/06 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë: "Për formën dhe përmbajtjen e "regjistrimit të emigrantëve " dhe procedurat e ndryshurara për regjistrim;
- Në 18.02.2016 Shqipëria ka miratuar ligjin Nr. 14/2016, "Për identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit".

VI.5. Politikat, strategjitë dhe planet e veprimit

Duke pranuar rëndësinë e fenomenit të migrantëve të kthyer[31], Qeveria Shqiptare ka miratuar në vitin 2010 Strategjinë për Ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer 2010-2015. Strategjia ka parashikuar një sërë masash që duhet të ndërmerren për ri-integrimin[32] e shtetasve shqiptarë

[28] Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit nr. 9668, datë 18.12.2016: " Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi".

[29] Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në nenin 29 të Ligjit nr. 9668, datë 18.12.2016: "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi"

[30] Neni Nr.141, i ndryshuar nga neni Nr.33. Profili vjetor i migrimit miratohet me urdhër të Ministrisë së Brendshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës. Profili i zgjeruar i migrimit është përgatitur në bashkëpunim me institucionet që janë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave statistikore të migracionit një herë në çdo katër vjet, gjatë nëntë muajve të parë të vitit pasardhës dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

[31] Migrantë të kthyer / migrim: Lëvizja i personit që kthehet në vendin e tij / saj të origjinës ose të qëndrimit të zakonshëm, pasi kalojnë të paktën një vit në një shtet tjetër. Kthimi i migrantëve përfshin kthimin vullnetar ose atë të detyrueshëm.

[32] Ri-integrim: (i) Ripërfshirje apo ritrupëzimi i një personi në një grup ose proces, p.sh. një migrant në shoqërinë

nga shtetet anëtare të BE-së.

Objektivi kryesor dhe masat e kësaj strategjie përfshijnë: (i) përmirësimin e kuadrit ligjor në mbështetje të ri-integrimit; (ii) sigurimin e një strukturë efektive në institucionet publike që do të garantojë mbështetjen e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer, dhe (iii) integrimin e qytetarëve shqiptarë në jetën ekonomike dhe sociale. Por, nga viti 2012 deri në vitin 2015, një fenomen i ri ka lindur d.m.th kërkimi i azilit në shtetet anëtare të BE-së, veçanërisht në Gjermani, Belgjikë, Francë, etj

Për këtë arsye,është vënë në dukje një proces intensifikimi i kthimit të emigrantëve shqiptarë në periudhën 2012-2015. Sipas INSTAT dhe IOM Tirana, 133,544 emigrantë shqiptarë mbi moshën 18 vjeç janë kthyer në Shqipëri gjatë 2009-2013. Në Tabelën Nr.1 është paraqitur numri i shtetasve shqiptarë të ndaluar në vendet e BE-së në periudhën 2012-2014.

Tabela Nr.1: Shtetasit shqiptarë të ndaluar në vendet e BE-së, në 2012-2014

Viti	2012	2013	2014
Shtetasit shqiptarë të ndaluar në BE	18,610	27,035	30,430
Shtetasit shqiptarë që iu është refuzuar hyrja në BE	13,195	12,980	14,275
Shtetasit shqiptarë që iu është kërkuar largimi nga BE	16,160	20,725	29,665

Burimi:Ministria e Punëve të Brendshme

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë 2014 një total prej 20,376 shtetas shqiptarë janë kthyer nga vendet e BE-së[33]. Detajet janë paraqitur në grafikun nr. 1.

Grafiku Nr. 1: Shtetasit shqiptarë të kthyer nga vendet e BE-së në 2012 - 2014



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, 2015

Më shumë se 95% e shtetasve shqiptarë të kthyer janë meshkuj (95% në 2012 dhe 96% në 2014). Shtimi i kthimit te qytetarëve shqiptarë ka ndodhur për arsye të ndryshme, të tilla si: (i) kthimi vullnetar i emigrantëve ekonomikë; (ii) kthimi i emigrantëve për shkak të krizës në vendet pritëse; (iii) kthimi i të miturve, të shoqëruar / pashoqëruar dhe, (iv) kthimi i detyruar.

e vendit të tij të origjinës ose të qëndrimit të zakonshëm; (ii) Ri-integrim (kulturor): Në kontekst të migracionit të kthimit, ripërshtatje e migrantit të kthyer me vlerat, mënyrën e jetesës, gjuhën, parimet morale, ideologjisë dhe traditave të shoqërisë së vendit të origjinës; (iii) Ri-integrim (ekonomik): Në kontekst të migracionit të kthimit, procesi nëpërmjet të cilit, migranti ripërfshihet në sistemin ekonomik të vendit të tij/saj të origjinës dhe i ofrohet mundësia të fitojë vetë jetesën. Në terma të zhvillimit, ri-integrimi ekonomik synon edhe shfrytëzimin e njohurive që ka marrë në vendin e huaj për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit të origjinës; (iv) Ri-integrim (social): Në kontekst të migracionit të kthimit, ripërfshirje e një migranti në strukturat shoqërore të vendit të tij/saj të origjinës. Kjo përfshin nga njëra anë krijimin e një rrjeti personal (miq, të afërm, fqinjë) dhe nga ana tjetër zhvillimin e strukturave të shoqërisë civile (shoqata, grupe të vetë-mbështetjes dhe organizata të tjera). Burimi: Migracioni i Kthimit dhe Ri-integrimi në Shqipëri 2013 – INSTAT dhe IOM.

[33] Profili i zgjeruar i migracionit shqiptar 2012-2014

Gjatë vitit 2014 është zhvilluar një total prej 1,928 operacionesh kthimi, 1,510 ose 76% nga Greqia, 73 nga Franca, dhe pjesa tjetër nga vende të ndryshme. Pasi kthehen përsëri në vend, për të përfituar nga mbështetja për punësim dhe formim profesional, emigrantët mund të regjistrohen në rrjetin e zyrave të punësimit. Shifrat tregojnë se ka një dallim të madh mes emigrantëve dhe të kthyerve të regjistruar në zyrat e punësimit gjatë periudhës 2012-2015. Për shembull, në vitin 2014 nga 20,376 të kthyer, vetëm 834 (ose 4%) janë regjistruar në zyrat e punësimit.

Komentet dhe rekomandimet e strategjive të përfunduara apo atyre në fuqi për të kthyerit dhe integrimin, si dhe emigracioni i parregullt,janë evidentuar në Progres Raportin e Shqipërisë për vitin 2016 publikuar nga Komisioni Europian më datë 9 nëntor 2016.

Shqipëria 2016 - Progres Raporti i BE-së mbi Migrimin e Ligjshëm dhe të Parregullt

-Mungesa që nga viti 2000 i një strategjie kombëtare ndërsektoriale për migrimin mbetet një çështje shqetësuese. Masat mbi çështjet e përgjithshme të migrimit në disa strategji sektoriale kombëtare: (i) mbrojtjja sociale dhe përfshirja, (ii) punësimi, biznesi dhe zhvillimi. Menaxhimi i integruar i kufirit dhe lufta kundër trafikimit te qenieve njerëzore shkaktoi rezultate te kufizuara.

-Strategjia për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer përfundoi në vitin 2015. Puna për një strategji të re nuk ka filluar ende.

-Një seksion specifik është përfshirë në strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin2015-2020, e miratuar në maj 2016.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar qëstruktura e politikave të emigracionit për motive punësimi të jetë koherente dhe zbatimi i tyre të mos dobësohet nga dispozitat ligjore kontradiktore.

Burimi: Progres Raporti për Shqipërinë 2016 nga Komisionin Europian, faqet 69-70

Rekomandime për Ri-integrimin

- Politikat e ri-integrimit për emigrantët e kthyer duhet të jenë më mirë të koordinuara për shkak të shumë aktorëve të përfshirë dhe rolit të paqartë dhe përgjegjësive të mbivendosura;
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të ndryshojë qasjen dhe të rrisë nivelin e mbështetjes me mënyra konkrete dhe me vizita në terren, dhe jo vetëm me këshilla që ofrohen nëpër zyra;
- Krijimi i një fondi të veçantë për ri-integrimin e azilkërkuesve të kthyer në mënyrë vullnetare;
- Rritja e rolit të pushtetit lokal. Zbutje fiskale dhe mbështetje konkrete për emigrantët e kthyer përmes një koordinimi më të mirë të të gjithë aktorëve në nivel rajonal dhe lokal.

Rekomandime për emigrimin

- Rritja e transparencës së informacionit mbi emigracionin dhe një transmetim i kujdesshëm i mesazhit në media, për të shmangur pritshmëritë e larta të të rinjve;
- Zhvillimi dhe zbatimi i procesit të akreditimit të Agjencive Private për Punësim për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe shmangien e problemeve që mund t'u ndodhin qytetarëve shqiptarë.

VII. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET PËR POLITIKAT PUBLIKE

Gjetjet e këtij studimi cilësor kërkimor tregojnë se vala e fundit e migrimit u karakterizua nga një përfshirje e përgjithshme të një natyre të gjerë, vendime të shpejta, nivel i ulët i rrezikut, shpenzime udhëtimi dhe informacion i njëanshëm mbi procedurat e migrimit të ligjshëm. Gjetjet mbi faktorët shtytës janë në përputhje me ato të studimeve të tjera të migrimit: Shqiptarët u larguan në kërkim të një të ardhme më të mirë për ta dhe për fëmijët e tyre, për të pasur perspektiva më të mira punësimi, kushte më të mira sociale dhe ekonomike dhe ndonjëherë edhe për shkak të pasigurisë fizike.

Në nivelin makro, kushtet ekonomike të migrantëve të ardhshëm u përkeqësuan pas krizës globale financiare në vitin 2008. Kriza ka nxitur kthimin e një numri të konsiderueshëm emigrantësh shqiptarë nga Greqia dhe Italia, rënien e konsiderueshme të remitancave nga jashtë, rritjen e nivelit të varfërisë, shkallën e lartë të papunësisë në veçanti midis të rinjve, si dhe ngadalësimin e aktivitetit ekonomik.

Një gjetje interesante është se nuk ka pasur përgatitje paraprake. Asnjë prej të intervistuarve nuk i kishte kushtuar kohë dhe vëmendje vendimit për të shkuar në Gjermani, ata nuk flisnin gjermanisht, as nuk kishin marrë me vete çertifikatat kualifikuese / diplomat e arsimit, edhe pse punësimi u deklarua si arsye kryesore për t'u larguar.

Faktorët shtytës drejt Gjermanisë përfshijnë zhvillimin ekonomik të këtij vendi, sistemin e organizuar mikpritës, pagesat me para në dorë për periudhën e pritjes, keqkuptimi i fjalimeve të zyrtarëve gjermanë dhe të diasporës shqiptare në Gjermani. Mungesa e njohurive mbi procedurat e emigrimit për motive punësimi, informacioni i dominuar nga njëanshmëria dhe gojëdhënat, ndikimi i fortë i të njohurve dhe pritshmëritë e larta për një kërkim të suksesshëm të punës bazuar në deklaratat se Gjermania kishte nevojë për fuqi punëtore, ndikuan pozitivisht në vendimin për të migruar në Gjermani.

Përvojat në Gjermani paraqesin një pamje të dyfishtë; qëndrimi në kampe u vlerësua në përgjithësi si një eksperiencë negative, veçanërisht në lidhje me kushtet e jetesës. Periudha pasi u larguan nga kampet, është ajo që të kthyerit kujtojnë pozitivisht. Mësimi kryesor i nxjerrë gjatë gjithë përpjekjeve të migrimit është nevoja për të njohur rregullat dhe respektimi i tyre. Për më tepër, ata tani kanë një vetëdije më të lartë se si funksionon një sistem i mirë dhe kjo mund të jetë një pikë referimi në përditshmërinë e tyre në Shqipëri dhe për pritshmëritë nga politika dhe administrata.

Shumica e të kthyerve janë sistemuar disi në Shqipëri. Ata i janë rikthyer stilit të jetës së mëparshme, por janë të vëmendshëm për mundësitë e migrimit. Duke qenë të vetëdijshëm për rregullat dhe procedurat, tashmë të intervistuarit do të dëshironin të migronin ligjërisht në Gjermani. Gjithashtu, ata janë duke marrë masa aktive si p.sh. mësimin e gjuhës, ndjekjen e kurseve të formimit profesional dhe marrjen e informacionit të duhur nga autoritetet përkatëse.

Faktorët kryesorë shtytës dhe tërheqës janë identifikuar në këtë studim dhe do të mbeten të vlefshëm për periudha relativisht të gjata: ndryshimi në nivelin e të ardhurave dhe zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, performanca e tregut të punës, dallimetnë standardet e jetesës, cilësia e arsimit dhe shpresat për të ardhmen. Këto dallime nuk janë të lehta për t'u kapërcyer dhe vazhdimisht do të ushqyejnë qëllimet e të rinjve shqiptarë për të migruar drejt Gjermanisë. Megjithatë, rregullimi dhe menaxhimi i potencialit të migrimit në mënyrë që të zbutet ndikimi i tij negativ si në Shqipëri, ashtu dhe në Gjermani, është shumë i rëndësishëm.

Strategjitë dhe planet e veprimit për migrimin duhet të adresojnë më mirë çështjen e informimit për mundësitë e migrimit dhe kanalet zyrtare, të përshtatura për segmente të ndryshme të të rinjve në bazë të karakteristikave demografike, aftësitë dhe potencialet e tyre. Duke pasur parasysh hendekun që ekziston në komunikimin midis institucioneve dhe individëve në Shqipëri, është e nevojshme që të identifikohen mënyra alternative dhe plotësuese të kapërcimit të pengesave dhe përmirësimin e përcjelljes së mesazheve dhe efekasitetin e tyre ndaj të rinjve.

Që të disponojmë një kuptueshmëri të qartë të ligjeve të azilit dhe procedurat e migrimit, harmonizimi i kritereve të azilit dhe qëndrimit në vendet anëtare të BE-së mund të jetë një hap i rëndësishëm.

Qeveria shqiptare mund ta trajtojë problemin e migrimit duke informuar publikun për kërkesat dhe mundësitë e migrimit, përshtatjen dhe përmirësimin e kurseve të AFP -se sipas nevojës së tregjeve vendase dhe ndërkombëtare të punës, të rrisë bashkëpunimin me shkollat e tjera të AFP-ve jashtë vendit për të siguruar aftësi më të përditësuara dhe zgjerojë ofertën e kurseve profesionale me kurse të gjuhëve të huaja. Një politikë e tillë do të ishte në dobi të individit dhe vendit, pavarësisht vendimit për të migruar pas përfundimit të kursit. Kjo do t'i pajiste ata me aftësitë e duhura për tregun global të punës. Përpjekje të veçanta duhet t'i kushtohen zonave rurale dhe malore në lidhje me qasjen e tyre në informacion dhe kurset e AFP-së.

Çdo përpjekje e autoriteteve gjermane për të kontribuar në informacion, trajnim dhe mekanizma të tjerë të tregut të punës, është mëse e nevojshme. Megjithatë, mendojmë se këto përpjekje mund të jenë më efikase nëse përshtaten me kontekstin dhe kulturën vendase. Kandidatët shqiptarë kanë nevojë për më tepër masa shoqëruese sesa punëkërkuesit standard gjermanë. Këto masa shoqëruese kushtojnë më pak, në rast se zbatohen direkt këtu, sesa kur migrantët e ardhshëm të jenë larguar nga Shqipëria.

Migrimi, dhe sidomos ai i të rinjve, ka karakterizuar gjithmonë Shqipërinë (me përjashtim të dukshëm të periudhës 1944-1990 nën regjimin komunist). Të rinjtë shqiptarë lëvizin për mundësi më të mira studimi, punësimi dhe perspektiva të jetës. Vala e migrimit gjatë periudhës 2014 - 2015 vulosi këtë karakteristikë "normale" të migrimit të të rinjve për shkak të faktorëve kontekstuale shtytës dhe tërheqës: një mjedis i vështirë socio-ekonomik në Shqipëri dhe mundësi me rrezikshmëri të ulët por përfitim të madh për tu sistemuar në Gjermani. Amplituda e lëvizjes është ndikuar nga keqinformimi dhe ndonjëherë nga interesa kriminale.

Megjithatë, migrimi i të rinjve shqiptarë nuk duhet të vëzhgohet si i kushtëzuar vetëm nga perspektiva për arsim dhe punësim më të mirë. Intervistat tona dhe studime të tjera, theksojnë se migrimi i të rinjve ka më së shumti të bëjë me qëllime më të rëndësishme, si zhvillimi i karrierës dhe objektiva të tjera të jetës. Këta njerëz janë në kërkim të së ardhmes së tyre: një punë dhe / ose mundësi më të mira arsimi janë pjesë e kërkesave në tërësinë e tyre. Nëpërmjet "lëvizjes së lirë" përtej kufijve, të rinjtë shqiptarë (dhe të Ballkanit Perëndimor) ndërtojnë karakterin e tyre, përcaktojnë aftësitë, dhe më e rëndësishmja kulturën e tyre të mirëkuptimit dhe tolerancës për "tjetrin". Këto janë lentet përmes së cilave duhet shqyrtuar migrimi i të rinjve nga Ballkani Perëndimor.

BIBLIOGRAFIA

Banka e Shqipërisë, 2015. Raporti i Stabilitetit Financiar 6M-2. https://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_Stabilitetit_Financiar_per_gjashtemujorin_e_dyte_te_vitit_2015_7488_1.php

Banka e Shqipërisë, 2015. Raporti i Stabilitetit Financiar 6M-1. https://www.bankofalbania.org/web/Financial_Stability_Report_2016_H1_7596_2.php?kc=0,27,0,0,0

European Asylum Support Office (EASO, 2015). Asylum Applicants from the Western Balkans: Comparative analysis of trends, push-pull factors and responses – Update. Available at: https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans_ Update_r.pdf

European Commission (2016). Albania 2016 Report. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf

Eurostat, 2016. Different annual data. http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_eirtn&lang=en

Filipi, Gj., Galanxhi, E., Nesturi, M., Grazhdani, T. (2014). Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri, 2013. ISBN: 978-9928-188-14-4 http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013.pdf

INSTAT (2011).Censusi i Popullsisë dhe Banesave. Rezultatet Kryesore. http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011/publications.aspx

Merkel, A. (2015). Fjala e Kancelares Federale, znj. Dr. Angela Merkel në Konferencën Ekonomike Gjermano-Shqiptare, 8 korrik 2015, Tiranë. http://www.tirana.diplo.de/contentblob/4564816/Daten/5633814/150708_Growort_Bundeskanzlerin.pdf

Ministria e Punëve të Brendshme (2015),Profili i Zgjeruar i Migracionit Shqiptar 2012-2014. http://www.albania.iom.int/publications/reports/Profili_i_zgjeruar_i_migracionit_ENG_web.pdf

SHTOJCA

Tabela 1. Të dhënat mbi aplikimet e azilkërkuesve nga Shqipëria në periudhën 2008 – 2015

	Aplikantët për azil									Aplikues për herë të parë							
	GJEO/ PERIUDHA	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Totali	BE[34]	1,135	2,065	1,925	3,080	7,500	11,065	16,950	67,740	615	1,305	1,075	2,860	6,875	10,555	16,145	65,935
	Gjermani	75	55	45	85	250	1,295	8,110	54,760	60	50	40	80	230	1,245	7,865	53,805
	Totali	1,220	2,120	1,965	3,190	7,760	11,400	17,305	68,740	675	1,350	1,110	2,950	7,115	10,830	16,465	66,780
Më pak se 14 vjeç	BE	110	250	220	735	1,920	2,920	4,500	18,685	60	210	180	690	1,750	2,765	4,335	18,335
	Gjermani	10	5	5	15	75	375	2,560	16,025	10	5	5	15	75	365	2,505	15,785
	Totali	120	255	225	760	1,980	3,000	4,595	18,955	65	215	185	715	1,810	2,835	4,420	18,570
Nga 14 deri në 17 vjeç	BE	60	145	90	315	720	1,065	1,555	4,480	95	100	70	295	665	1,030	1,505	4,390
	Gjermani	0	0	0	5	30	90	465	3,180	0	0	0	5	25	90	450	3,130
	Totali	65	145	95	320	745	1,085	1,590	4,560	100	100	75	305	695	1,050	1,535	4,460
Nga 18 deri në 34 vjeç	BE	710	1,290	1,230	1,345	3,380	4,765	7,535	31,220	365	730	575	1,250	3,160	4,600	7,175	30,405
	Gjermani	50	35	35	45	90	545	3,475	24,775	45	30	35	40	80	530	3,370	24,390
	Totali	760	1,325	1,255	1,400	3,500	4,915	7,690	31,675	400	755	600	1,290	3,265	4,720	7,310	30,780
Nga 35 deri në 64 vjeç	BE	245	340	350	625	1,410	2,180	3,140	13,125	90	220	220	570	1,235	2,025	2,925	12,575
	Gjermani	10	10	5	25	55	275	1,580	10,630	5	5	5	20	45	255	1,510	10,350
	Totali	270	350	360	650	1,465	2,260	3,220	13,320	105	235	225	585	1,275	2,090	2,990	12,735
Mbi 65 vjeç	BE	10	25	15	40	40	80	95	215	0	25	10	35	40	70	90	215
	Gjermani	0	0	0	0	0	10	35	155	0	0	0	0	0	10	35	155
	Totali	10	25	15	40	40	80	95	215	0	25	10	35	40	70	90	215
Total meshkuj	BE	860	1,500	1,390	1,890	4,425	6,275	9,930	41,105	495	880	700	1,730	4,060	5,640	9,445	40,035
	Gjermani	60	45	35	55	140	745	4,585	33,005	50	40	30	45	125	715	4,430	32,410
	Totali	930	1,540	1,420	1,965	4,600	6,475	10,150	41,735	545	915	725	1,790	4,210	5,805	9,640	40,565
Meshkuj nën 14 vjeç	BE	65	135	115	410	1,030	1,545	2,420	9,985	35	115	100	385	945	1,370	2,330	9,820
	Gjermani	5	5	0	5	45	200	1,345	8,540	5	5	0	5	45	195	1,310	8,420
	Totali	70	140	115	425	1,070	1,585	2,470	10,130	35	120	100	400	980	1,405	2,380	9,950

[34] Në28 vendet e BE-së

Meshkuj nga 14 deri në17 vjeç	BE	45	125	65	245	535	805	1,160	2,900	90	85	50	230	500	765	1,135	2,845
	Gjermani	0	0	0	5	20	60	275	1,910	0	0	0	5	15	60	265	1,880
	Totali	50	125	70	250	560	820	1,180	2,960	95	90	55	235	520	775	1,155	2,895
Meshkujnga 18 deri në 34 vjeç	BE	585	1,000	960	845	1,990	2,635	4,450	20,240	300	525	395	770	1,860	2,380	4,225	19,745
	Gjermani	45	30	30	30	45	325	2,055	16,100	40	25	25	25	40	315	1,990	15,835
	Totali	625	1,025	975	880	2,070	2,730	4,550	20,545	330	545	415	800	1,930	2,460	4,310	19,995
Meshkuj nga 35 deri në 64 vjeç	BE	165	220	235	365	830	1,220	1,810	7,870	65	135	135	320	720	1,065	1,665	7,520
	Gjermani	5	10	5	10	30	160	900	6,395	5	5	0	10	25	145	845	6,210
	Totali	185	230	245	380	870	1,275	1,860	7,995	80	145	145	330	750	1,100	1,705	7,620
Meshkuj mbi 65 vjeç	BE	5	10	5	20	20	35	40	95	0	10	5	20	20	30	35	95
	Gjermani	0	0	0	0	0	0	15	65	0	0	0	0	0	0	15	65
	Totali	5	10	5	20	20	40	40	95	0	10	5	20	20	35	35	95
Totale femra	BE	280	565	530	1,190	3,075	4,705	7,005	26,570	125	420	375	1,130	2,800	4,245	6,685	25,835
	Gjermani	15	10	10	30	115	545	3,520	21,700	10	10	10	30	105	535	3,430	21,340
	Totali	290	575	540	1,220	3,160	4,830	7,140	26,935	135	435	385	1,155	2,880	4,355	6,815	26,150
Femra më pak se 14 vjeç	BE	45	115	105	325	885	1,365	2,075	8,655	25	95	80	305	800	1,240	2,000	8,475
	Gjermani	5	5	5	5	35	175	1,215	7,445	5	5	0	5	35	170	1,190	7,330
	Totali	50	115	110	335	915	1,405	2,120	8,775	30	100	85	315	825	1,275	2,040	8,580
Femra nga 14 deri në 17 vjeç	BE	15	20	25	70	180	255	395	1,570	5	15	20	70	165	215	365	1,535
	Gjermani	0	0	0	0	10	30	190	1,265	0	0	0	0	10	30	180	1,245
	Totali	15	20	25	70	190	260	405	1,595	5	15	20	70	170	225	375	1,555
Femra nga 18 deri në 34 vjeç	BE	130	290	270	505	1,390	2,070	3,085	10,970	65	205	175	480	1,290	1,875	2,950	10,645
	Gjermani	10	5	10	15	45	220	1,415	8,670	5	5	5	15	40	220	1,375	8,545
	Totali	135	295	275	515	1,430	2,125	3,140	11,120	70	210	185	490	1,330	1,915	3,000	10,780
Femra nga 35 deri në 64 vjeç	BE	85	120	115	265	580	940	1,330	5,250	25	85	85	250	510	845	1,260	5,050
	Gjermani	0	0	0	10	25	115	685	4,230	0	0	0	10	20	110	665	4,135
	Totali	85	120	115	270	595	965	1,360	5,315	25	90	85	255	525	870	1,285	5,110
Femra mbi 65 vjeç	BE	5	10	5	20	20	40	60	120	0	10	5	20	20	40	55	120
	Gjermani	0	0	0	0	0	5	20	90	0	0	0	0	0	5	20	90
	Totali	5	10	5	20	20	40	60	120	0	10	5	20	20	40	55	120

Burimi: EUROSTAT, 2016 http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_asyappctza&lang=en

Tabela 2. Të dhënat vjetore mbi vendimet e para dhe përfundimtare të kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë

		Vendimet për kërkesat e para								Vendimet përfundimtare të kërkesave							
	GJEO/ PERIUDHA	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Vendimet përfundimtare për shtetasit shqiptarë	BE	1,080	1,615	1,290	2,010	4,590	7,320	13,390	41,410	470	585	655	765	2,130	2,175	6,480	28,635
	Gjermani	50	60	35	65	115	485	3,005	31,590	25	30	15	40	45	170	1,595	23,265
	Totali	1,130	1,660	1,320	2,070	4,770	7,595	13,690	42,035	525	635	680	805	2,205	2,370	6,715	28,945
Totali i vendimeve pozitive	BE	145	180	125	250	545	615	1,070	1,085	130	105	140	175	225	340	695	755
	Gjermani	10	5	5	15	15	35	75	75	5	15	5	0	5	5	20	55
	Totali	150	180	125	250	545	615	1,085	1,105	135	105	140	180	225	345	695	755
Statusi i Konventës së Gjenevës	BE	55	75	45	75	370	245	215	175	85	40	70	60	75	150	240	280
	Gjermani	0	5	0	0	0	5	10	5	0	0	0	0	0	0	0	5
	Totali	60	75	45	75	370	245	220	175	85	40	70	60	75	150	240	280
Statusi humanitar	BE	65	70	55	115	120	225	330	485	:	:	15	45	60	105	150	135
	Gjermani	5	5	0	0	5	15	25	35	5	15	5	0	0	0	15	35
	Totali	65	70	60	115	120	225	335	500	:	:	15	45	60	110	150	135
Refuzime	BE	940	1,435	1,165	1,760	4,045	6,705	12,320	40,325	340	480	515	590	1,905	1,840	5,785	27,885
	Gjermani	40	50	30	55	105	450	2,930	31,515	25	20	10	40	40	170	1,580	23,210
	Totali	980	1,480	1,190	1,815	4,225	6,980	12,610	40,935	385	530	540	625	1,980	2,025	6,020	28,190

Burimi: EUROSTAT, 2016 http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_asyappctza&lang=en

This work is licensed under a Creative Commons Attribution-NonCommercial-NoDerivatives 4.0 International License (CC BY-NC-ND 4.0).
You are free to Share - copy and redistribute the material in any medium or format under the following terms:

* *Attribution - You must give appropriate credit, provide a link to the license, and indicate if changes were made. You may do so in any reasonable manner, but not in any way that suggests the licensor endorses you or your use.*
* *Non Commercial - You may not use the material for commercial purposes.*
* *No Derivatives - If you remix, transform, or build upon the material, you may not distribute the modified material.*
* *No additional restrictions - You may not apply legal terms or technological measures that legally restrict others from doing anything the license permits.*

For more information about the license that this material is published please visit: creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0